



Akademia e Drejtësisë



Shkolla e Magjistraturës

MBROJTJA E MJEDISIT PËRMES TË DREJTËS PENALE

Afrim Shala

Tiranë, 11-12 dhjetor 2023

AUTORI :

Afrim Shala, gjyqtar, Gjkata Supreme e Kosovës

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës

© Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

MOHIMI I PËREGJEGJËSISË

Pikëpamjet e autorit nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	4
Objektivat trajnuese	4
Metodologjia trajnuese	5
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	5
Burimet dhe literatura.....	6
I. LIBRA DHE BOTIME TJERA.....	6
II. AKTE JURIDIKE	9
MBROJTJA E MJEDISIT PËRMES TË DREJTËS PENALE	11
1. Shqyrtime të përgjithshme.....	11
2. Akte juridike dhe dokumente të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.....	14
2.1. Shqyrtime të përgjithshme	14
2.2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	15
2.3. Ligjet përkatëse për mbrojtjen e mjedisit.....	18
2.4. Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale	19
2.5. Direktiva 2008/99 e Parlamentit Europian dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”	22
3. Praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet mjedisore.....	24
4. Disa nga veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	29
4.1. Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit (neni 338)	29
4.1.1. Shqyrtime të përgjithshme	29
4.1.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	32
4.1.3. Disa raste nga praktika gjyqësore	32
4.2. Mbrojtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme (neni 339)	34
4.2.1. Shqyrtime të përgjithshme	34
4.3. Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit (neni 341)	37
4.4. Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve (neni 342)	39
4.5. Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinarë (neni 344)	40
4.6. Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve (neni 345)	41
4.6.1. Shqyrtime të përgjithshme	41
4.6.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	42
4.7. Shkretërimi i pyjeve (neni 348)	43
4.7.1. Shqyrtime të përgjithshme	43
4.7.2. Veprat penale të kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	45
4.7.3. Disa raste nga praktika gjyqësore	46
4.8. Vjedhja e pyllit (neni 349)	47
4.8.1. Shqyrtime të përgjithshme	47
4.8.2. Disa raste nga praktika gjyqësore	48
4.9. Gjuetia e kundërligjshme (neni 350).....	49

4.9.1. Shqyrtime të përgjithshme	49
4.9.2. Disa raste nga praktika gjyqësore	51
4.10. Peshkimi i kundërligjshëm (neni 353)	52
4.10.1. Shqyrtime të përgjithshme	52
4.10.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	53
4.10.3. Disa raste nga praktika gjyqësore	53
4.11. Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 354).....	54
4.11.1. Shqyrtime të përgjithshme	54
4.11.2. Veprat penale të kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë	56
5. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli	56
SHTOJCË.....	57
I. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	57
KAPITULLI XXVII	57
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE	57
II. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.....	66
KREU IV	66
VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT	66

Hyrje

Në një epokë ku ndotja e mjedisit është bërë një sfidë globale, mbrojtja e mjedisit ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në botën bashkëkohore. Studimet dhe hulumtimet e kësaj sfide tregojnë se përpjekjet për të ruajtur dhe promovuar mjedisin janë të domosdoshme për të garantuar të ardhmen tonë dhe të brezave të ardhshëm.

Në përpjekje për të arritur këtë synim të rëndësishëm, shumë shtete bashkëkohore kanë penalizuar një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit, duke i parashikuar si vepra të kundërligjshme, qoftë në formë të veprave penale (kundërvajtjeve penale), kundërvajtjeve, shkeljeve administrative dhe shkeljeve të tjera. Këto masa kanë për qëllim të kujdesen për të drejtën e qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Përveç masave juridiko-penale, janë ndërmarrë edhe masa të tjera, duke përfshirë ato me karakter edukativo-arsimor, politik, ekonomik dhe social, që synojnë të ndikojnë në sjelljen dhe qëndrimin e individëve dhe shoqërisë në përgjithësi ndaj mjedisit.

Gjithashtu, janë krijuar edhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, parti politike, agjencione, ministri të posaçme dhe institucione të tjera, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Ky angazhim, është shprehje e kujdesit global ndaj shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, ndërsa një mbrojtje e tillë e mjedisit është e garantuar edhe me kushtetutat e shteteve të ndryshme dhe me marrëveshje të shumta ndërkombëtare.

Shprehja “mjedis” ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshëm, që nënkupton rrethinën natyrore: ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

Në këtë mënyrë, trajtimi i këtyre çështjeve mjedisore në tryeza dhe forume të ndryshme në mes të gjyqtarëve dhe profesionistëve të tjetër vlerësohet se është i një rëndësie të veçantë.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

1) Aplikojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të pjesës së posaçme të kodit penal që i referohen veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore;

2) Kuptojnë në mënyrë sa më të qartë elementet e figurave të veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, duke pasur parasysh edhe marrëveshjet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi;

3) Njohin dallimet dhe ngjashmëritë e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe

4) Evitojnë disa nga dilemat eventuale që do të mund të paraqiteshin në praktikën gjyqësore e që kanë të bëjnë me veprat penale të lartcekura.

Metodologjia trajnuese

Gjatë këtij trajnimi dy (2) ditore që do të mbahet në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë, do të përdoren metodat e kombinuara të shpjegimit dhe diskutimit të çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Në këtë drejtim, do të ketë diskutime interaktive me pjesëmarrësit nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës, ndërsa të gjitha çështjet që trajtohen me pjesëmarrësit, do të jenë të prezantuara edhe me Power Point.

Nga pjesëmarrësit, përkatësisht nga gjyqtarët nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës do të kërkohet që të paraqesin përvojat e tyre dhe sfidat që janë përballur gjatë gjykimit të veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore. Gjithashtu, pjesëmarrësit do t'i paraqesin pikëpamjet e tyre lidhur me temat konkrete nga praktika gjyqësore që kanë të bëjnë veprat penale të lartcekura, duke i pasur parasysh edhe specifikat e vendit të tyre.

Të gjitha temat e lartcekura që kanë të bëjnë me veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore do të trajtohen duke i marrë për bazë edhe rastet nga praktika gjyqësore, si dhe do të trajtohen edhe çështje që ndërlidhen me harmonizimin e legjislacionit penal të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë me dokumentet dhe instrumentet ndërkombëtare.

Gjithashtu, pjesëmarrësve do t'ju ofrohen edhe vendime të ndryshme nga praktika gjyqësore që i referohen veprave penale të lartcekura, si dhe do t'ju prezantohen dokumentet dhe instrumentet më të rëndësishme që ndërlidhen me këto vepra penale.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Gjatë këtij trajnimi, nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, duke dhënë kontributin e tyre në diskutime, në mënyrë që me pjesëmarrjen e tyre aktive të ndihmojnë në arritjen e objektivave dhe synimeve të këtij trajnimi.

Përveç këtyre, nga pjesëmarrësit pritet që të parashtrorjnë pyetje, të ofrojnë zgjidhje dhe sugjerime gjatë gjithë kohës sa zgjatë programi trajnues.

Burimet dhe literatura

Përveç materialeve të prezantuara nga trajnuesi, pjesëmarrësit mund të shfrytëzojnë edhe burimet dhe literaturën e shënuar më poshtë.

I. LIBRA DHE BOTIME TJERA

ALEXANDER, LARRY;

FERZAN KIMBERLY

KESSLER: *Crime and Culpability, A Theory of Criminal Law*, Cambridge, 2009.

BARAKU, IRMA: *E Drejta për Informim mbi Çështjet e Mjedisit: Legjislacioni Shqiptar në Vështrim Krahasues me Konventën e Aarhus-it*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore Vol. 5 (2013), fq.16-29.

BEGEJA, SKENDER: *Kriminalistika I dhe II*, Tiranë, 2001.

BERGMAN, PAUL;

BERGMAN-BARRET,

SARA: *The Criminal Law Handbook, Know Your Rights, Survive the System*, Fifth Edition, Berkely, 2003.

BIANKU, LEDI;

KUMBARO, ODETA: *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Botimi i katërt, Strasburg, 2017.

BOHLANDER,

MICHAEL: *Principles of German Criminal Law*, Oxford and Portland, Oregon, 2009.

CEKA, JONKA: *E drejta penale në mbrojtje të mjedisit*, JUS & JUSTICIA / NR.10 / Tiranë, 2014, fq.72-81.

DABULLA, AVNI: *E drejta ndëshkimore e formular prej mësimëve të dhënura në kursin praktik të drejtësisë*, Tiranë, 1923.

DRESSLER, JOHN: *Criminal Law*, Third Edition, Santa Monica, 1996.

ELEZI, ISMET;

KAÇUPI, SKËNDER;

HAXHIA, MAKSIM: *Komentar i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë, 2004.

ELLIOT,

CATHERINE;

QUIN, FRANCES: *Criminal Law*, Third Edition, "Pearson Education", Harlow, 2000.

FLETCHER,

GEORGE: *Basic Concepts of Criminal Law*, Oxford University Press, New York-Oxford, 1998.

- FIONDA, JULIA,
BRYANT,
MICHAEL: *Briefcase on Criminal Law*, Second Edition, Cavendish Publishing Limited, London, 2000.
- HAJDARI, AZEM: *Procedura penale, Komentar*, Prishtinë, 2009.
- HALILI, RAGIP : *Kriminologjia*, Prishtinë, 2009.
- HALL, E. DANIEL: *Criminal Law and Procedure*, Fifth Edition, Delmar Cengage, New York, 2009.
- HALL, JEROME: *General principles of criminal law*, Second Edition, Indianapolis, 1990.
- HALLEVY,
GABRIEL: *A Modern Treatise on the Principle of Legality in Criminal Law*, Sprinder, London, 2010.
- HALPIN, ANDREV: *Definition in the Criminal Law*, Hart Publishing, Oxford, 2004.
- HASANI, ENVER;
ČUKALOVIĆ,
IVAN: *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I*, Prishtinë, 2013.
- HERRING,
JONATHAN: *Criminal law*, Third Edition, “Palgrave Maxmillan“, Bristol, 2002.
E drejta penale, Teori, kazuse dhem ateriale, Botim V/Volumi I, Tiranë, Tetor 2013.
Criminal Law, The Basic, Routledge, Abingdon, 2010
- HORVATIĆ,
ŽELJKO: *Novo hrvatsko kazнено pravo*, Zagreb, 1997.
- HYSESANI,
AGRON;
SHKURTI, ALTIN: *Komentar i Kodit Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2001.
- HYSI, VASILIKA: *Hyrje në kriminologji dhe penologji*, Tiranë, 2002.
- ISMAILI, HILMI;
SEJDIU, FATMIR: *Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës*, Prishtinë, 2000.
- KAMBOVSKI,
VLLADO: *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Shkup, 2007.
- KAPLAN, JOHN: *Criminal Law*, Third Edition, Boston, 1996.
- LATIFI, VESEL: *Kriminalistika*, Prishtinë, 2001.
- LUARASI, ALEKS: *Kodi penal me praktikë gjyqësore*, Tiranë, 2003.
- MANJA, ULSI: *Veprat penale kundër mjedisit (neni 201-207 KP)*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Tiranë, Shtator 2017.
- MOLAN, MIKE: *Cases and materials on criminal law*, Fourth Edition, London and New York, 2008.

- MUÇI, SHEFQET: *E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2006.
- PERKINS, ROLLIN;
BOYCE, ROLAND: *Criminal law*, Third Edition, Mineola, 1982.
- PETROVIQ,
BORISLLAV: *E drejta penale*, Sarajevë/Prishtinë, 2006.
- JEAN, PRADEL;
CORSTENS, GEERT;
VERMEULEN,
GERT: *E drejta penale evropiane*, Tiranë, 2009.
- ROXIN, CLAUDIUS: *Strafprozessordnung mit Einführungsgesetz Gerichtsverfassungsgesetz, EGGVG Jugenderichtsgesetz Straßenverkehrsgesetz*, München, 2006.
- SAHITI, EJUP;
MURATI, REXHEP: *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016.
- SALIHU, ISMET: *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2016.
E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005.
E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014.
- SALIHU, ISMET;
ZHITIJA, HILMI;
HASANI,
FEJZULLAH: *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Komentar*, Botimi I, 2014, Prishtinë.
- SAMAHA, JOEL: *Criminal Law*, Tenth Edition, wadsworth, Cengage Learning, 2011.
- SCALIA, VALERIA: *The European Court of Human Rights and Environmental Crime*, Catania, January 2015.
- SHALA, AFRIM: *Kompetencat e gjyqarorit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës*, Revista “Justicia”, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2009.
Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010.
Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.
Përmbledhje e ligjëratave nga “E drejta penale I”, Gjilan, 2011.
Sistemet kryesore të caktimit të dënimit me gjobë në të drejtën penale bashkëkohore, Revista “E drejta”, Nr.2-2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2011, faqe 129-136.
Roli i shërbimit sprovues në shqiptimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, Gjilan, 2011.
Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Revista “Avokatura”, nr.14, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, faqe 15-31.

Organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës sipas Ligjit për gjykatat, Revista shkencore “Norma”, Gjilan, 2012.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Moduli Trajnues, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2012, (bashkautor). <http://jus.igjk.rks-gov.net/239/>
Veprat penale kundër të drejtave të votimit, “Opinio Juris”, Revistë shkencore juridike, Akademia e Drejtësisë, Viti I, nr.1, Prishtinë, 2015. <http://jus.igjk.rks-gov.net/564/>

Doracaku për procedurë penale, Prishtinë, 2015, (bashkautor). <http://jus.igjk.rks-gov.net/523/>

Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike “Opinio Juris”, Akademia e Drejtësisë, Viti II, nr.2, Prishtinë, 2016.

<http://jus.igjk.rks-gov.net/741/1/Afrim%20shala-Shqip.pdf>

Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2018. <http://jus.igjk.rks-gov.net/768/>

Modelet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, Prishtinë, 2021, (bashkautor). <http://jus.igjk.rks-gov.net/801/>

Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2012. <http://jus.igjk.rks-gov.net/806/>

Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2023 (bashkautor). <http://jus.igjk.rks-gov.net/833/>

Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023.

Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale dhe civile, Prishtinë, 2023 (bashkautor).¹

Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë, 2023, (kontribues).²

SHEGANI, ALTIN : *E drejtë penale e krahasuar*, Tiranë, 2002.

II. AKTE JURIDIKE

Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale, e nënshkruar në Strasburg më datën 04.11.1998;

¹ https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/PermbledhjaII_GJSshq_.pdf

² https://ad.rks-gov.net/Uploads/Documents/Vendime_perzgjedhura_GJS_ADshq_.pdf

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Këshilli i Europës, 1950;

Konventa e Këshillit të Europës mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin që rezultojnë nga Aktivitetet e Rrezikshme për Mjedisin, e nënshkruar në Lugano më 21.06.1993;

Direktiva 2008/99 e Parlamentit European dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”, e nënshkruar është më datën 19.11.2008;

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10.12.1948;

Konventa e Aarhusit, e miratuar më 25.06.1998 në Aarhus të Danimarkës;

Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e shtresës së Ozonit;

Konventa e Baselit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturinave të Rrezikshme dhe Depozitimin e tyre;

Protokolli i Montrealit;

Protokolli i Kiotos;

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimaterike;

Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i datës 23.06.2022;

Ligji Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollimin e Integruar të Ndotjes, i datës 26.03.2009;

Ligji Nr.08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i datës 25.02.2010;

Ligji Nr.03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës, i datës 30.09.2010;

Ligji Nr.08/L-181 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i datës 15.12.2022;

Ligji Nr.04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, i datës 19.03.2013;

Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet, i datës 22.07.2010;

Ligji nr.04/L-060 Për Mbeturina, i datës 24.05.2012;

Ligji Nr.2004/21 Për Veterinarinë, i datës 16.06.2004;

Ligji Nr.08/L-137 Për Pyjet, i datës 09.03.2023;

Ligji Nr.02/L-53 Për Gjuetinë, i datës 16.12.2005;

Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë, i datës 10.10.2006;

Ligji Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, i datës 09.10.2006;

Ligji Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, i datës 31.07.2013;

Ligji Nr.04/L-110 Për Ndërtimin, i datës 31.05.2012;

Ligji Nr.03/L-039 Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, i datës 20.02.2008;

Ligji Nr.03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i datës 30.09.2010

Ligji Nr.02/L-102 Për Mbrojtjen nga Zhurma, i datës 17.03.2008;

Ligji Nr.04/L-197 Për Kimikate, i datës 27.02.2014 dhe

Ligji Nr.06/L-029 Për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, i datës 30.03.2018.

MBROJTJA E MJEDISIT PËRMES TË DREJTËS PENALE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Mbrojtjes së mjedisit nga ndotja në botën bashkëkohore i kushtohet një rëndësi e madhe.

Në këtë drejtim, në shumë shtete bashkëkohore janë parashikuar si vepra të kundërligjshme, qoftë në formë të veprave penale, kundërvajtjeve, kundërvajtjeve penale, shkeljeve administrative, etj. një mori veprimesh që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit.

Përveç masave të karakterit juridiko-penal, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, janë ndërmarrë edhe masa tjera të karakterit edukativo-arsimor, politik, ekonomik, social, etj.

Gjithashtu, janë krijuar edhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, parti politike, agjencione, ministri të posaçme, etj., me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.³

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, çështja e mbrojtjes së mjedisit është e garantuar edhe me dispozitat kushtetuese të shteteve të ndryshme dhe me shumë marrëveshje dhe instrumente juridike ndërkombëtare.

Sipas këtyre marrëveshjeve dhe instrumenteve juridike ndërkombëtare, shtetet janë detyruar që në legjislacionet e tyre penale të parashohin si vepra penale një mori të veprimesh që ndërmirren ndaj mjedisit, e me të cilat dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i njerëzve, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Përveç me dispozita të ligjeve dhe akteve tjera, mjedisi në përgjithësi mbrohet edhe me dispozitat juridike penale, përkatësisht me të drejtën penale.

Është e ditur se funksionin mbrojtës në përgjithësi, e drejta penale e realizon duke parashikuar se cilat vepra apo sjellje konsiderohen vepra penale, kushtet për përgjegjësi penale dhe duke parashikuar sanksione penale, si dhe masa tjera ndaj kryesve të veprave penale.⁴

Andaj, edhe funksionin e mbrojtjes së mjedisit, e drejta penale e realizon duke parashikuar se cilat vepra apo sjellje të drejtuara kundër mjedisit konsiderohen vepra penale, kushtet për përgjegjësi penale dhe duke parashikuar sanksione penale, si dhe masa tjera ndaj kryesve të veprave penale të tilla.

Këto dispozita ligjore të cilat parashohin veprat penale kundër mjedisit, kushtet për përgjegjësi penale, si dhe sanksionet penale dhe masat tjera që mund të shqiptohen ndaj kryesve të veprave të tilla penale e përbëjnë **“të drejtën penale mjedisore”**.

³ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010, f. 253.

⁴ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, f. 20.

Veprat e tilla penale janë të parashikuara në Kapitullin XXVII-të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës⁵ dhe ky Kapitull emërtohet si **“Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore”**, kurse, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë,⁶ këto vepra penale (kundërvajtje penale) janë të parashikuara në Kreun IV-të dhe emërtohen si **“Vepra penale kundër mjedisit”**.

Ky Kapitull i veprave penale, si në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë, gjatë viteve të fundit ka pësuar disa ndryshime dhe plotësime, si në drejtim të parashkimit të disa veprave penale të reja, duke u harmonizuar me dokumentet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, ashtu edhe në drejtim të ndryshimeve të disa aspekteve tjera të veprave penale ekzistuese.

Përveç kësaj, ky Kapitull i veprave penale, gjatë viteve të fundit, ka pësuar ndryshime edhe në këto aspekte:

- te disa vepra penale është ndryshuar struktura e veprimeve të kryerjes;
- te disa vepra penale janë shtuar disa paragrafë në të cilat janë parashikuar disa forma të veprave penale përkatëse;
- për disa vepra penale është parashikuar që gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmer masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor;
- për disa vepra penale krahas dënimit me burgim në mënyrë alternative është parashikuar edhe mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë;
- për disa vepra penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe me burgim;
- te disa vepra penale është ndryshuar lartësia e dënimit, etj.

Objekt mbrojtës i këtij Kapitulli të veprave penale është mjedisi, kafshët, bimët dhe objektet kulturore.⁷

Pasojë e shumicës së veprave penale që janë të parashikuara në këtë Kapitull, është rrezikimi konkret dhe abstrakt i mjedisit.

Mirëpo, për të ekzistuar disa forma të këtyre veprave penale duhet që të jetë edhe bërë dëmtimi i të mirës juridike që është e mbrojtur me anë të këtyre veprave penale.

Shumica e veprave penale të këtij kapitulli janë të karakterit blanket, ngase lidhur me përcaktimin e tipareve të figurës së këtyre veprave penale, duhet aplikuar edhe ligjet tjera që rregullojnë çështje të caktuara nga fusha mjedisore.

Kryes i veprave penale të këtij Kapitulli në të shumtën e rasteve mund të jetë çdo person, si personat fizik, ashtu edhe personat juridik.

⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, i datës 23 nëntor 2018 (në tekstin e mëtejme: KPRK). KPRK mund të gjendet në këtë link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.7895, i datës 27.01.1995 (në tekstin e mëtejme: KPRSH). KPRSH mund të gjendet në këtë link: <https://qbz.gov.al/preview/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

⁷ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 253.

Pra, shumica e veprave penale kundër mjedisit janë të ashtuquajtura *“delicta communia”*⁸ - vepra penale të cilat mund t'i kryejë çdo person.

Veprat penale të këtij Kapitulli, mund të kryhen me dashje, kurse format e lehta të disa veprave penale mund të kryhen edhe nga pakujdesia.

Gjithashtu, përveç me këtë Kapitull të KPRK-së, mjedisi në përgjithësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë indirekte mbrohet edhe me kapitujt e tjerë të KPRK-së.

Mirëpo, tek kapitujt e tjerë të KPRK-së, bëhet fjalë për vepra penale që kanë si objekt mbrojtës disa vlera dhe të drejta tjera, por që në një mënyrë, mbrohen edhe shumë aspekte mjedisore.

Në këtë drejtim vlen të përmenden këto vepra penale:

- *“Kryerja e veprës terroriste”*, nga neni 129 lidhur me nenin 128, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6. të KPRK-së;
- *“Trajnimi për terrorizëm”*, nga neni 133, paragrafi 2 të KPRK-së;
- *“Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar”*, nga neni 145, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.4. të KPRK-së;
- *“Krimet e luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar”*, neni nga neni 147, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.15 të KPRK-së;
- *“Përvetësimi, pranimi, shfrytëzimi, prodhimi, posedimi, transferi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive”*, nga neni 170 të KPRK-së;
- *“Kanosja për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo të grabitjes së materialit nuklear ose radioaktiv”*, nga neni 171 të KPRK-së;
- *“Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike”*, nga neni 357 të KPRK-së;
- *“Ndërtimi pa leje”*, nga neni 359 të KPRK-së, etj.

Përveç këtyre, mbrojtja e mjedisit në kuptimin juridiko penal është e parashikuar edhe me nenin 80 të Ligjit për Miniera dhe Minerale,⁹ që në praktikën tonë gjyqësore kemi pasur disa raste tilla, kur personat fizik dhe juridik janë akuzuar dhe shpallur fajtor/përgjegjës sipas kësaj dispozite ligjore.

⁸ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, f. 54.

⁹ Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Minerale, i datës 22.07.2010, i ndryshuar dhe plotësuar me disa ligje të mëvonshme.

2. Akte juridike dhe dokumente të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit

2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Mbrojtja e mjedisit bëhet përmes akteve juridike dhe dokumenteve të ndryshme, si të brendshme, ashtu edhe ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, në kuadër akteve juridike të brendshme, është e rëndësishme që të theksohet, se mbrojtja e mjedisit garantohet dhe mbrohet edhe me:

- **Kushtetutat e Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë,**
- **Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë;**
- **Ligje të ndryshme dhe**
- **Një numër i konsiderueshëm i udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të ndryshme, si në nivel lokal të komunave (bashkive), ashtu edhe në nivel qendror.**

Në planin ndërkombëtar, mbrojtja e mjedisit, në përgjithësi, garantohet dhe mbrohet me konventa dhe instrumente të ndryshme, si në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në kuadër të organizatave të ndryshme kontinentale dhe rajonale.

Në këtë aspekt, numri i Konventave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi mjedisin është i shumtë, por ndër Konventat më të rëndësishme janë:

- **Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e shtresës së Ozonit;**
- **Konventa e Baselit mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturinave të Rrezikshme dhe Depozitimim e tyre;**
- **Konventa e Aarhusit;**
- **Protokolli i Montrealit;**
- **Protokolli i Kiotos dhe**
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimaterike.¹⁰**

Në kuadër të Komunitetit European, mbrojtja e mjedisit sigurohet nëpërmjet legjislacionit primar dhe sekondar, sipas fushave të ndryshme dhe atë në mënyrë direkte apo indirekte.¹¹ Përveç kësaj, në Komunitetin European është zhvilluar edhe legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit përmes së drejtës penale, i cili

¹⁰ MANJA, ULSI, *Veprat penale kundër mjedisit (neni 201-207 KP)*, Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, Tiranë, Shtator 2017, fq. 48. Për më shumë informacion mbi Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin shih <http://www.unep.org/>

¹¹ <https://eur-lex.europa.eu/summary/chapter/20.html> dhe <https://eeb.org/work-areas/environmental-law-and-justice/EU-environmental-law/>

është zhvilluar, më vonë sesa ajo sipas fushave të veçanta mjedisore. E drejta europiane mjedisore ekziston tashmë prej mëse 30 vjetësh dhe janë në fuqi më shumë se 200 direktiva në fushën mjedisore, pa përmendur këtu aktet normative dytësore europiane.¹²

Në kuadër të Këshillit të Europës është e rëndësishme që të përmenden dy (2) konventa:

- **Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale dhe**
- **Konventa mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin që rezultojnë nga Aktivitetet e Rrezikshme për Mjedisin.**¹³

Gjithashtu, në këtë drejtim, duhet të përmendur edhe **Rekomandimin nr.1614/2003 të datës 27.06.2003 për mjedis dhe të drejta të njeriut** të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës,¹⁴ në të cilën ju rekomandohet qeverive të shteteve anëtare që:

- 1) Të sigurojnë mbrojtje përkatëse të jetës, shëndetit, familjes, jetës private, integritetit fizik dhe pronës private të personave në përputhje me nenet 2, 3 dhe 8 të KEDNj dhe nenit 1 të Protokollit Shtesë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit;
- 2) Të njohin të drejtën e njeriut për një mjedis të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe modest, i cili e përfshinë detyrimin objektiv të shteteve për ta mbrojtur mjedisin me ligjet vendase, preferohet në nivel kushtetues;
- 3) Të mbrojnë të drejtat procedurale të individëve për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore, ashtu siç përcaktohet në Konventën e Aarhusit.

Kurse, në kuadër të Bashkimit European, vlen të përmendet **Direktiva 2008/99 e Parlamentit European dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”**.

2.2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës¹⁵ janë rregulluar dhe parashikuar çështje që ndërlidhen me përgjegjësinë për mjedisin jetësor.¹⁶

¹² CEKA, JONKA, *E drejta penale në mbrojtje të mjedisit*, JUS & JUSTICIA, NR.10, Tiranë, 2014, fq.73-75.

¹³ Kjo Konventë e Këshillit të Europës është nënshkruar në Lugano më 21.06.1993. Tekstin e kësaj Konvente mund ta gjeni në këtë link: <https://rm.coe.int/168007c079>

¹⁴ <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17131&lang=en>

¹⁵ Kushtetutën e Republikës së Kosovës mund ta gjeni: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

¹⁶ Gjithashtu, edhe në nenin 7, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar se “*Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut*”.

Në paragrafin 1 të këtij neni është parashikuar se *“Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin”*, kurse në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar se *“Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton”*.

Gjithashtu, në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar se *“Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve”*.

Prezumimi i të drejtës për shëndet fizik dhe psikik është e drejtë e njeriut për mjedis të shëndetshëm jetësor. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i pranon të drejtat e reja ekologjike, në atë mënyrë që ia garanton secilit të drejtën për mjedis të shëndetshëm jetësor dhe për njoftim me kohë dhe të plotë për gjendjen e tij. Ndërkaq, kësaj të drejte i përgjigjet edhe obligimi i çdo personi që të ketë kujdes për natyrën dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik. Ky është obligim i përgjithshëm njerëzor, sepse ka të bëjë me çdo njeri.¹⁷

Andaj, bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, shihet që secilit person i garantohet e drejta për mjedis të shëndetshëm jetësor dhe e drejta për njoftimin me kohë për çështjet e mjedisit. Duhet vënë në pah, se e drejta për informim për çështjet e mjedisit është bazike për të arritur një qëllim të përbashkët që është mbrojtja e mjedisit dhe krijimi i kushteve mjedisore të shëndetshme për çdo individ.¹⁸

Gjithashtu, në këtë nen është përcaktuar edhe obligimi i institucioneve të pushtetit publik që të angazhohen me qëllim të garantimit të mundësive për çdo person që të mund të ndikojë në vendimet që merren për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Përveç institucioneve publike, secili është i detyruar që ta mbrojë dhe përmirësojë mjedisin jetësor dhe një gjë e tillë është parashikuar në mënyrë shprehimore në dispozitën e lartcekur, në të cilën thuhet se *“natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë obligim i çdo njeriu”*.

Duke pasur parasysh se Kushtetuta e Republikës së Kosovës vetëm parimisht e rregullon përgjegjësinë për mjedisin jetësor dhe nuk e trajtohen më hollësisht këtë aspekt, atëherë, konkretizimin e dispozitave kushtetuese mund ta gjejmë në një numër të konsiderueshëm të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe në një numër tejet të madh të udhëzimeve dhe rregulloreve të miratuara nga institucionet tjera, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror.

¹⁷ HASANI, ENVER; ČUKALOVIĆ, IVAN: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Komentar, Botimi I, Prishtinë, 2013, fq.197.

¹⁸ BARAKU, IRMA: *E Drejta për Informim mbi Çështjet e Mjedisit: Legjislacioni Shqiptar në Vështrim Krahasues me Konventën e Aarhus-it*, Revista Shqiptare për Studime Ligjore Vol. 5 (2013), fq.16.

Është e rëndësishme që theksohet se edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në praktikën e saj gjyqësore kishte shqyrtuar raste që ndërlidhen me të drejtën për mjedis.

Kështu, në rastin Nr. KI 56/09 - Parashtruesit "*Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*",¹⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, njëzëri kishte konstatuar shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me Nenin 52(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në këtë rast, objekt i shqyrtimit ishte kërkesa e parashtruesve të lartcekur për vlerësimin e kushtetueshmërisë së vendimit Nr.01/011-3257, të datës 30.04.2019 të nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Me këtë vendim të Kuvendit Komunal të Prizrenit ishte ndryshuar Plani Detal Urban, për ish-lagjen "*Jaglenica*", tani "*Dardania*", në Prizren, në atë mënyrë zona e gjelbërt ekzistuese e kësaj lagje është ndryshuar në zonë për ndërtimin e objekteve të larta, të planifikuara për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale.

Parashtruesit e kërkesës u ankuan se u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 52(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilën dispozitë është parashikuar se "*Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton*", ndërsa në këtë rast, asnjë debat publik dhe/apo pjesëmarrje e publikut nuk i parapriu miratimit të vendimit të kundërshtuar të Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Andaj, edhe kjo ishte arsye që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konstatoi se në këtë rast kemi të bëjmë me shkeljen e lartcekur të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ndërsa, në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**²⁰ gjenden dy (2) nene që rregullojnë çështje nga fusha e mjedisit.

Kështu, në nenin 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar e drejta e çdokujt që të informohet me gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, kurse në nenin 59, paragrafi 1, pikat d) dhe dh) është parashikuar se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, si dhe shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

¹⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. Ref.: RK 77/10, i datës 22.12.2010.

²⁰ Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë mund ta gjeni duke klikuar ueb-sajtin e Qendrës së Botimeve Zyrtare në këtë link: <https://qbz.gov.al/previeë/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

E drejta e çdokujt që të informohet me gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, sipas nenit 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është një e drejtë që në rrafshin ndërkombëtar garantohet dhe sigurohet edhe me Konventën e Aarhus-it.²¹

2.3. Ligjet përkatëse për mbrojtjen e mjedisit

Si në Republikën e Kosovës, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë, mbrojtja e mjedisit është rregulluar dhe parashikuar edhe me ligje të veçanta, varësisht nga fushat specifike që ndërlidhen me këtë çështje.

Në këtë drejtim, në Republikën e Kosovës, si ligje më të rëndësishme që i referohen mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi janë:

- Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i datës 23.06.2022;
- Ligji Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollimin e Integruar të Ndotjes, i datës 26.03.2009;
- Ligji Nr.08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i datës 25.02.2010;
- Ligji Nr.03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës, i datës 30.09.2010;
- Ligji Nr.08/L-181 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i datës 15.12.2022;
- Ligji Nr.04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, i datës 19.03.2013;
- Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet, i datës 22.07.2010;
- Ligji Nr.04/L-060 Për Mbeturina, i datës 24.05.2012;
- Ligji Nr.2004/21 Për Veterinarinë, i datës 16.06.2004;
- Ligji Nr.08/L-137 Për Pyjet, i datës 09.03.2023;
- Ligji Nr.02/L-53 Për Gjuetinë, i datës 16.12.2005;
- Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë, i datës 10.10.2006;
- Ligji Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, i datës 09.10.2006;
- Ligji Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, i datës 31.07.2013;
- Ligji Nr.04/L-110 Për Ndërtimin, i datës 31.05.2012;
- Ligji Nr.03/L-039 Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, i datës 20.02.2008;
- Ligji Nr.03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i datës 30.09.2010;
- Ligji Nr.02/L-102 Për Mbrojtjen nga Zhurma, i datës 17.03.2008;
- Ligji Nr.04/L-197 Për Kimikate, i datës 27.02.2014;

²¹ Republika e Shqipërisë tani më e ka nënshkruar Konventën e Aarhus-it me ligjin nr.8672, të datës 26.10.2000 “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Aarhusit”. Sipas nenit 5, paragrafi 1 të Konventës së Aarhus-it, autoritetet publike duhet të sigurojnë: a) Zotërimin dhe përditësimin e informacionit mjedisor që lidhet me funksionet e tyre; b) Krijimin e sistemeve detyruese për të siguruar një rrjedhje të përshtatshme të informacionit mbi mjedisin për tek autoritetet e tjera dhe c) Informimin e publikut për masat parandaluese apo që mund të zvogëlojnë dëmin në rast të kërcënimit të shëndetit nga veprimtari të ndryshme apo shkaqe të ndryshme natyrore. Përveç të drejtës së publikut për informacion lidhur me mjedisin, Konventa e Aarhus-it parasheh edhe të drejtën e publikut për pjesëmarrje në vendimarrje lidhur me çështjen e mjedisit dhe të drejtën për t’u drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin. https://environment.ec.europa.eu/law-and-governance/aarhus_en

- Ligji Nr.06/L-029 Për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore, i datës 30.03.2018, etj.

2.4. Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale

Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale është një dokument i Këshillit të Europës që është nënshkruar në Strasburg më datën 04.11.1998.²²

Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale është njëri prej akteve më të rëndësishme të Këshillit të Europës që i dedikohet mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Përveç që është dokumenti më i rëndësishëm i Këshillit të Europës, Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Drejtës Penale është konventa e parë ndërkombëtare që inkriminon veprat që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme mjedisore dhe nënshkrimi i saj përbën një ngjarje shumë të rëndësishme në zhvillimin e ligjit penal mjedisor.

Kjo Konventë synon inkriminimin e të gjitha veprimeve të paligjshme të drejtuara kundër mjedisit dhe që rrezikojnë edhe shëndetin njerëzor. Qëllimi i saj është të garantojë një mbrojtje më të mirë të mjedisit nëpërmjet zbatimit të sanksioneve penale në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Europës. Konventa ka gjithashtu për qëllim që të harmonizojë legjislacionet e brendshme penale të shteteve, duke parashikuar elemente të rinj të veprave penale të drejtuara ndaj mjedisit, sanksionet përkatëse, përgjegjësinë penale dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në luftën kundër krimit mjedisor.²³

Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale i detyron shtetet kontraktuese që të parashikojnë dispozita të veçanta në ligjet penale kombëtare apo të modifikojnë ligjet ekzistuese.

Siç është theksuar edhe më lart, kjo Konventë parashikon një numër të konsiderueshëm të veprave penale të kryera me dashje ose nga pakujdesia, që shkaktojnë vdekjen ose shkaktimin e lëndimit të rëndë të njeriut, apo ka të ngjarë që të shkaktojnë dëme substanciale në cilësinë e ajrit, të tokës, ujit, kafshëve ose bimëve.

Konventa përcakton konceptin e përgjegjësisë penale të personave fizikë dhe juridikë, masat që duhet të miratohen nga shtetet për të mundësuar konfiskimin e pasurisë dhe përcaktimin e kompetencave të autoriteteve, si dhe shtron rrugën për bashkëpunim ndërkombëtar. Edhe në këtë Konventë, masat përfshijnë dënime me burgim, sanksione mbi pasurinë dhe mund të përfshijnë rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme. Një dispozitë e rëndësishme parashikon mundësinë e shoqatave të mbrojtjes së mjedisit për të marrë pjesë në procedurën penale lidhur me shkeljet e parashikuara me Konventë.²⁴

²² <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treaty-num=172>

²³ MANJA, ULSI, *Veprat penale kundër mjedisit (neni 201-207 KP)*, fq. 54.

²⁴ CEKA, JONKA, *E drejta penale në mbrojtje të mjedisit*, JUS & JUSTICIA, NR.10, Tiranë, 2014, fq.74-75.

Në nenin 2 të Konventës janë parashikuar veprat penale të kryera me dashje, për të cilat shtetet kontraktuese duhet që të ndërmarrin masa që në legjislacionet e tyre t'i parashohin si vepra penale.

Vepra të tilla penale të kryera me dashje sipas kësaj dispozite ligjore të Konventës janë:

- a) shkarkimi, emetimi ose futja e një sasive të substancave ose të rrezatimit jonizues në ajër, tokë ose ujë, të cilat:
 - shkaktojnë vdekje ose lëndim të rëndë ndonjë personi ose
 - krijojnë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar vdekje ose lëndim të rëndë ndonjë personi;
- b) shkarkimi, emetimi ose futja e paligjshme e një sasive të substancave ose të rrezatimit jonizues në ajër, tokë ose ujë që shkaktojnë ose ka gjasa që të shkaktojnë përkeqësimin e tyre, vdekje ose lëndim të rëndë të ndonjë personi ose dëmtim thelbësor në monumentet e mbrojtura, objekte të tjera të mbrojtura, prona, kafshë ose bimë;
- c) depozitimi, trajtimi, ruajtja, transportimi, eksportimi ose importimi i kundërligjshëm i mbeturinave të rrezikshme të cilat shkaktojnë ose ka gjasa të shkaktojnë vdekje, lëndim të rëndë të ndonjë personi ose dëm substancial të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve apo bimëve;
- d) funksionimi i paligjshëm i një impianti, në të cilin kryhet një veprimtari e rrezikshme dhe e cila shkakton ose ka gjasa të shkaktojë vdekje ose lëndim të rëndë të ndonjë personi ose dëme substanciale të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve apo bimëve;
- e) prodhimi, trajtimi, magazinimi, përdorimi, transportimi, eksportimi ose importimi i paligjshëm i materialeve bërthamore, materialeve ose substancave të tjera të rrezikshme radioaktive të cilat shkaktojnë ose ka gjasa të shkaktojnë vdekje, lëndim të rëndë të ndonjë personi ose dëm substancial të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve apo bimëve.²⁵

Gjithashtu, shtetet kontraktuese do të duhej që në legjislacionin e brendshëm të parashohin përgjegjësi penale edhe për personat që ndihmojnë ose nxitin (shtytin) kryerjen e veprave penale të lartcekura, si dhe të parashohin përgjegjësi penale edhe në rastet kur veprat penale të lartcekura kryhen nga pakujdesia.²⁶

Në nenin 4 të Konventës janë të parashikuar si vepra të tjera penale ose shkelje administrative të cilat pavarësisht se mund të jenë kryer me dashje apo pakujdesi duhet të parashikohen si të tilla në legjislacionet e brendshme të shteteve kontraktuese.

Vepra të tilla konsiderohen:

- a) shkarkimi, emetimi ose futja e paligjshme të një sasive të substancave ose rrezatimit jonizues në ajër, tokë ose ujë;

²⁵ Neni 2, paragrafi 1 i Konventës.

²⁶ Neni 2, paragrafi 2 dhe neni 3, paragrafi 1 i Konventës.

- b) shkaktimi i paligjshëm i zhurmës;
- c) asgjësimi, trajtimi, magazinimi, transportimi, eksportimi ose importimi i paligjshëm i mbeturinave;
- d) funksionimi i paligjshëm i një impianti;
- e) prodhimi, trajtimi, përdorimi, transportimi, eksportimi ose importimi i paligjshëm i materialeve bërthamore, lëndëve të tjera radioaktive apo kimike të rrezikshme;
- f) shkaktimi i paligjshëm i dëmtimeve që ndryshojnë komponentët natyrorë të një parku kombëtar, rezervave natyrore ose zonave tjera të mbrojtura;
- g) posedimi, marrja, dëmtimi, vrasja ose tregtimi i paligjshëm i florës dhe faunës apo specieve të tjera të egra të mbrojtura.

Secili shtet kontraktues duhet që të miratojë, në përputhje me instrumentet përkatëse ndërkombëtare, masat dhe sanksionet e duhura që mund të jenë të nevojshme, e të cilat marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave penale.

Sanksionet e tilla përfshijnë dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe mund të përfshijnë rivendosjen e mjedisit.²⁷

Konventa, gjithashtu, parashikon që çdo shtet kontraktues duhet që të miratojë masat që janë të nevojshme për të konfiskuar instrumentet dhe të ardhurat ose pasurinë, vlera e të cilave korrespondon me të ardhurat në lidhje me veprat penale të kryera e të theksuara më lart.²⁸

Në nenin 9 të Konventës është parashikuar edhe përgjegjësia e personave juridikë, sipas të cilit çdo shtet kontraktues do të miratojë masat e duhura të nevojshme për të vendosur sanksione penale apo administrative ose masa për personat juridikë në emër të të cilit është kryer një nga veprat penale të mësipërme nga organet e tyre, nga anëtarë të saj ose nga një tjetër përfaqësues i tyre, kurse në nenin 10 të Konventës është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve, sipas së cilës çdo shtet kontraktues do të miratojë masat e duhura të nevojshme për të siguruar që autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Në nenin 11 të Konventës është parashikuar e drejta e shoqatave apo fondacioneve që të marrin pjesë në procedura penale, ku përfshihen vepra penale të lartcekura.

Kështu, çdo shtet kontraktues, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, do t'i japë të drejtë çdo grupi, fondacioni ose shoqate e cila sipas statutit të saj synon mbrojtjen e mjedisit, të drejtën për të marrë pjesë në procedurat penale në lidhje me veprat penale të parashikuara me këtë Konventë.

²⁷ Neni 6 i Konventës.

²⁸ Neni 7 i Konventës.

Kurse, në nenin 12 të Konventës është parashikuar bashkëpunimi ndërkombëtar që ndërlidhet me hetimin dhe gjykimin e veprave penale të theksuara më lart.

2.5. Direktiva 2008/99 e Parlamentit European dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale”

Direktiva 2008/99 e Parlamentit European dhe Këshillit “Mbi Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet të Drejtës Penale” është një dokument tjetër i rëndësishëm i Bashkimit European që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit.

Kjo Direktivë është nënshkruar në Strasburg më datën 19.11.2008²⁹ dhe në të janë të parashikuara masat që duhet ndërmarrë përmes ligjit penal për ta mbrojtur mjedisin në mënyrë sa më efektive.

Ngashëm sikurse edhe Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale, edhe përmes kësaj Direktive, janë detyruar shtetet anëtare që në legjislacionet e tyre penale të parashohin si vepra penale një mori të veprimeve që ndërlidhen me mjedisin, me anë të të cilave shkaktohet ose mund të shkakohet vdekje ose lëndim të rëndë të çdo personi ose dëmtim të konsiderueshëm të cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës ose të cilësisë së ujit apo për kafshët apo bimët.

Sipas kësaj Direktive, këto veprime duhet të parashikohen si vepra penale, si në rastet kur kryhen me dashje, ashtu edhe në rastet kur kryhen nga pakujdesia.

Veprimet të cilat duhet të parashihen si vepra penale nga shtetet anëtare janë:

- a) shkarkimi, emetimi ose futja e një sasi të materialeve ose rrezatimi jonizues në ajër, tokë ose ujë;
- b) grumbullimi, transporti, rikuperimi ose asgjësimi i mbeturinave, duke përfshirë mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin e mëpasshëm të vendeve të depozitimit dhe duke përfshirë veprimet e ndërmarra si tregtar ose ndërmjetës (menaxhimi i mbetjeve);
- c) dërgimi i mbetjeve, kur ky aktivitet bie në objektin e nenit 2 (35) të Rregullores (KE) në një sasi jo e papërfillshme, qoftë e ekzekutuar në një dërgesë të vetme ose në disa dërgesa që duket se janë të lidhura;
- d) operimi i një impianti në të cilin kryhet një aktivitet i rrezikshëm ose në të cilin magazinohen ose përdoren substanca ose preparate të rrezikshme;
- e) prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, mbajtja, magazinimi, transporti, importi, eksporti ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera të rrezikshme radioaktive;

²⁹ Këtë Direktivë mund ta gjeni në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32008L0099>

- f) vrasja, shkatërimi, zotërimi ose marrja e specieve të mbrojtura të faunës ose florës së egër;
- g) tregtimi i specieve të mbrojtura të faunës ose florës së egër ose pjesëve ose derivateve të tyre;
- h) ndonjë sjellje që shkakton përkeqësim të konsiderueshëm të një habitati brenda një zone të mbrojtur dhe
- i) prodhimi, importimi, eksportimi, vendosja në treg ose përdorimi i substancave që shkatërrojnë ozonin.³⁰

Bazuar në nenin 4 të kësaj Direktive, duhet që shtetet anëtare të sigurojnë që nxitja, ndihma dhe nxitja e sjelljes së qëllimshme për të kryer veprat penale të lartcekura të konsiderohet gjithashtu vepër penale.

Sipas kësaj Direktive, shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që veprat penale të lartcekura të dënohen me dënime penale efektive, proporcionale dhe bindëse.³¹

Përveç personave fizik, duhet që edhe personat juridik të shpallën penalisht përgjegjës për kryerjen e veprave penale të lartcekura dhe shtetet anëtarë do të marrin masat e nevojshme për të siguruar se personat juridik do të dënohen me dënime penale efektive, proporcionale dhe bindëse.³²

³⁰ Neni 3 i Direktivës.

³¹ Neni 5 i Direktivës.

³² Nenet 6 dhe 7 të Direktivës.

3. Praktika gjyqësore e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet mjedisore

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut,³³ e nënshkruar në Romë më datën 04.11.1950, është konsideruar si instrumenti i parë që kristalizoi dhe dha efekt detyrues për të drejtat e përcaktuara në Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut.³⁴

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përmban **të drejta absolute** të cilat nuk mund të shkelen apo cenohen nga shtetet, siç janë: e drejta për jetë ose ndalimi i torturës, si dhe mbron **të drejta dhe liri të caktuara të cilat mund të kufizohen vetëm me ligj, kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike**, siç janë: e drejta për liri dhe siguri ose e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

Me miratimin e protokolleve shtesë, një numër të drejtave i janë shtuar tekstit fillestar të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut që kanë të bëjnë veçanërisht me heqjen e dënimit me vdekje, mbrojtjen e pronës, të drejtën për zgjedhje të lira ose lëvizjen e lirë.

Në anën tjetër, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, është organi gjyqësor i Këshillit të Europës, që shqyrton kërkesa nga individë, por edhe kërkesa ndërshtetërore, të paraqitura nga një shtet kundër një shteti tjetër që është palë në Konventë. Aktualisht janë 46 vende që kanë marrë përsipër të sigurojnë të drejtat dhe liritë themelore, jo vetëm për shtetasit e tyre, por për të gjithë personat tjerë, brenda juridiksionit të tyre.³⁵

Fillimisht duhet theksuar se fjala "**mjedis**" nuk përmendet në dispozitat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe aq më pak koncepti i të drejtës për një mjedis të shëndetshëm.

Në këtë mënyrë, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk e parasheh në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse një individ ka të drejtë për një mjedis të shëndetshëm.

Megjithatë, e drejta për një mjedis të shëndetshëm njihet në praktikën gjyqësore europiane përmes një interpretimi të gjerë të fushës së zbatueshmërisë të disa të drejtave të tjera, të parashikuara shprehimisht në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Andaj, edhe shkelja ose cenimi i të drejtës për një mjedis të shëndetshëm nuk mund të jetë arsye bazë dhe e vetme për inicimin e ndonjë rasti para Gjykatës Europiane të të Drejtave të

³³ Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, së bashku me protokollet shtesë, mund ta gjeni duke klikuar në këtë link: https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqj

³⁴ Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut mund ta gjeni duke klikuar në këtë link: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73775>

³⁵ *Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, Një instrument i gjallë*, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Strasburg, Shtator 2022.

Njeriut, pasi nuk mbrohet në mënyrë specifike nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Siç përcakton Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në praktikën e saj gjyqësore: “*ndotja e mjedisit mund të ndikojë negativisht në [...] jetën private dhe familjare të individit [...]. Megjithatë element vendimtar i cili duhet të jetë i pranishëm në përcaktimin nëse, në rrethanat e rastit, ndotja e mjedisit ka cenuar negativisht një nga të drejtat e mbrojtura nga paragrafi 1 i nenit 8, është ekzistenca e një efekti të dëmshëm mbi sferën private apo familjare të një personi dhe jo thjeshtë përkeqësimin e përgjithshëm të mjedisit*”.³⁶

Me fjalë të tjera, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk përmban ndonjë dispozitë me atë të së cilës mbrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shprehimore e drejta për një mjedis të shëndetshëm.

Mirëpo, pavarësisht kësaj, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut i ka dhënë zgjidhje çështjeve mjedisore, duke i zbatuar nenet tjera të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe atë të drejtën për jetë, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, ndalimi i torturës, etj.

Në vijim, do të paraqiten disa raste të tilla mjedisore që janë trajtuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj).³⁷

1) Rasti “*Hamer kundër Belgjikës*”, kërkesa nr.21861/03, e datës 27.11.2007.

Ankuesja kishte në pronësi një shtëpi të ndërtuar nga prindërit e saj në një pyll, ku nuk lejoheshin ndërtimet e tilla. Autoritetet shtetërore filluan procedurat për shembjen e shtëpisë, pasi ajo ishte ndërtuar në kundërshtim me legjislacionin pyjor dhe ankuesja duhet të kthente tokën në gjendjen e mëparshme. Autoritetet e rrënuan shtëpinë në fjalë, ndërsa ankuesja u ankua se e drejta e saj për jetën private ishte shkelur.

GjEDNj u shpreh për herë të parë, që edhe duke mos u mbrojtur shprehimisht në Konventë, mjedisi është një vlerë në vetvete, të cilën edhe shoqëria dhe autoritetet publike kanë interes për ta mbrojtur. Qëllimet ekonomike dhe madje edhe e drejta e pronës, nuk duhet të kenë përparësi përballë shqetësimeve mjedisore. Autoritetet kishin vepruar për të mbrojtur mjedisin, kur kishin vendosur që ta rrënonin shtëpinë e ndërtuar në pyll, kështu që nuk ka shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës (“*Mbrojtja e pronës*”).

³⁶ SCALIA, VALERIA, *The European Court of Human Rights and Environmental Crime*, Catania, January 2015, fq. 6.

³⁷ SCALIA, VALERIA, vepra e cituar, fq.8-17.

2) Rasti “Guerra dhe të tjerët kundër Italisë” - Kërkesa nr.116/1996/735/932, e datës 19.02.1998

Ankuesit ishin banorë të qytetit Manfredonia që ndodhej një (1) kilometër larg një fabrike kimike që prodhonte plehra. Fabrika kimike lëshonte një mori substancash të rrezikshme, duke përfshirë oksid nitrik, amoniak, trioksid arseniku dhe gaz të ndezshëm, që mund të shkaktojë një shpërthim. Për shkak të atmosferës lokale dhe kushteve tjera, emetimet që u shkaktuan nga kjo fabrikë lëviznin rregullisht drejtpërdrejt mbi qytetin Manfredonia, ndërsa ankuesit nuk kishin pasur mundësi që të informoheshin në lidhje me rreziqet e fabrikës kimike.

GjEDNj vendosi njëzëri se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”), pasi shkarkimet e dëmshme toksike të fabrikës kimike përbënin një ndërhyrje të konsiderueshme në të drejtën e respektimit të jetës dhe shtëpisë private dhe familjare.

GjEDNj, pastaj përcaktoi se autoritetet italiane nuk morën masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur ankuesit nga emetimet toksike.

GjEDNj konstatoi se raportet për sigurinë nuk i janë transmetuar asnjëherë popullatës lokale, e cila nuk kishte informacione për fabrikën e plehrave dhe ankuesit nuk ishin në gjendje të vlerësonin rrezikun për shëndetin e tyre.

Në këtë mënyrë, GjEDNj vendosi që autoritetet italiane nuk arritën të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të së drejtës sipas nenit 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”).

3) Rasti “Taskin dhe të tjerët kundër Turqisë”, kërkesa nr.46117/99, e datës 10.11.2004.

Ankuesit, të cilët jetonin rreth fshatit Bergama, banonin të gjithë brenda dhjetë (10) kilometrave nga një vend minierash. Në muajin Shkurt të vitit 1992, autoritetet i dhanë një kompanie minerare të drejta për të operuar në një minierë ari, e cila përfshinte autorizimin për të përdorur kullimin e cianidit për nxjerrjen e arit.

GjEDNj vendosi se shteti ka shkelur nenin 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”), sepse autoritetet duhet t'u kishin ofruar ankuesve informacionin e nevojshëm për të vlerësuar rrezikun për shëndetin e tyre. Kjo përbënte një dështim për të ndërmarrë hapa të arsyeshëm dhe të duhur për të mbrojtur të drejtat e ankuesve për respektimin e jetës private dhe familjare.

4) Rasti “Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar”, kërkesa nr.36022/97, e datës 08.07.2003

Ankuesit, të cilët jetonin rreth dymbëdhjetë (12) kilometra larg aeroportit “Heathrow”, pretenduan se zhurma nga fluturimet e natës ju shkaktonte shqetësime të konsiderueshme në gjumin e tyre. Në vitin 1993, Sekretari i Shtetit për Transport miratoi një sistem kuotash të kufizimeve të fluturimit natën (“Skema e 1993”) që synonte të arrijë një ekuilibër të duhur midis nevojave të banorëve lokalë dhe interesit ekonomik të mbajtjes së një aeroporti ndërkombëtar 24 orë.

GjEDNj vendosi se nuk kishte shkelje e nenit 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”), me arsyetimin se interesat e kërkuësve janë marrë në konsideratë siç duhet, kur është vendosur që të zbatohet “Skema e vitit 1993”.

GjEDNj u mbështet në informacionin statistikor për të arritur në përfundimin se shqetësimet e zhurmës për ankuesit që rrethonin aeroportin “Heathrow” ishin "të papërfillshme" dhe për këtë arsye nuk peshojnë më shumë se interesi thelbësor i komunitetit ekonomik për mbajtjen e një aeroporti ndërkombëtar 24-orë (*Testi i proporcionalitetit, duke marrë parasysh interesa të ndryshme konfliktuale*).

GjEDNj, gjithashtu vuri në dukje se ankuesit mund të kishin gjetur vendbanime të reja, pa një humbje të konsiderueshme. Kështu, në vlerësimin e interesave konkurruese të individit dhe të komunitetit në tërësi, GjEDNj besonte se autoriteti kombëtar (Sekretari i Shtetit për Transport) duhet t'i jepet një hapësirë e gjerë vlerësimi në marrjen e masave për të zbutur zhurmën nga aeroporti.

Qëndrim të njejtë, GjEDNj ka mbajtur edhe në rastin “*Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*”, kërkesa nr. 9310/81, e datës 21.02.1990.

5) Rasti “Moreno Gomez kundër Spanjës”, kërkesa nr.41343/02, e datës 16.11.2004

Ankuesi jetonte në një zonë që kishte disa bare dhe klube nate që shkaktonte shumë zhurmë, të cilat edhe ja bënin të vështirë që ai të flejë. Ankuesi pretendoi se moszbatimi i niveleve të lejueshme të zhurmës përbente shkelje të nenit 8 të Konventës.

GjEDNj vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”), e cila mund të ndodhë nëpërmjet ndërhyrjeve jofizike në shtëpinë e një personi, të tilla si zhurma, emetimet dhe erërat, për sa kohë që një “shkelje e tillë është serioze”.

GjEDNj e konsiderojë këtë si një shkelje të rëndë dhe konstatojë se autoritetet nuk arritën të siguronin një ekuilibër të drejtë midis interesave të ankuesit në gëzimin paqësor të shtëpisë së tij dhe interesit të komunitetit për klubet e natës.

6) Rasti “Lopez Ostra kundër Spanjës”, kërkesa nr.16798/90, e datës 09.12.1994

Ankuesja ankohej për ndotjen e shkaktuar nga një fabrikë për trajtimin e lëkurës, e cila lëshonte gaz, tym dhe erë, duke shkaktuar probleme për njerëzit që jetonin pranë saj. Për më tepër, vajza e ankueses vuante nga sëmundje të ndryshme, që shkaktonin të vjella dhe anoreksi, që sipas mjekut pediatër ishin rezultat i ndotjes.

GjEDNj pranoi kërkesën, duke konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës (“*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”), pasi nuk ishte vënë në të njëjtën balancë interesi ekonomik i vendit (duke pasur një fabrikë për trajtimin e lëkurës) dhe e drejta e ankueses për të pasur një jetë të qetë private dhe familjare.

Qëndrim të njejtë, GjEDNj ka mbajtur edhe në rastin “*Giacomelli kundër Italisë*”, kërkesa nr.59909/00, e datës 02.11.2006.

7) Rasti “Elefteriadis kundër Rumanisë”, kërkesa nr.38427/05, e datës 25.01.2011

Ankuesi ishte duke e mbajtur dënimin me burgim të përjetshëm për vrasje. Ndërmjet viteve 1994 dhe 2000, ankuesi ishte në dhomën e burgut 13.81 metër² me tre duhanpirës. Ankuesi argumentoi se ekspozimi i tij i pavullnetshëm ndaj tymit, i shkaktoi sëmundje pulmonare dhe përbënin shkelje të nenit 3 të Konventës.

GjEDNj vendosi njëzëri se kishte shkelje të nenit 3 të Konventës (“*Ndalimi i torturës*”), sepse autoritetet kishin për detyrë të merrnin masa për të mbrojtur shëndetin e ankuesit, duke e larguar atë nga duhanpirësit. Në vend të kësaj, autoritetet e detyruan ankuesin të ekspozohet në disa vende ku pihej duhani, edhe atë kundër rekomandimit të mjekut të tij.

4. Disa nga veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore

4.1. Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit (neni 338)

4.1.1. Shqyrtime të përgjithshme

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1. të nenit 338 të KPRK-së, e kryen kushdo që duke e shkelur ligjin, bën ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore.

Sic shihet, kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me ligje të posaçme është rregulluar mbrojtja e ajrit, ujit, tokës dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Dispozita ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, gjenden në disa ligje dhe akte nënligjore,³⁸ përkatësisht udhëzime administrative,³⁹ por vlen të përmenden : Ligji për mbrojtjen e mjedisit,⁴⁰ Ligji për parandalimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes,⁴¹ Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,⁴² Ligji për mbrojtjen e natyrës,⁴³ Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,⁴⁴ Ligji për Ujërat e Kosovës,⁴⁵ Ligji për Minierat dhe Mineralet,⁴⁶ etj.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në:

- a) ndotjen e ajrit, ujit ose tokës;
- b) degradimin e ajrit, ujit ose tokës;
- c) shkatërrimin e ajrit, ujit ose tokës apo
- d) në shfrytëzimin jashtë mase të burimeve natyrore.

³⁸ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 254.

³⁹ Udhëzime administrative dhe akte tjera juridike, përfshirë rregullore të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, mund të gjenden në ueb-sajtin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë: <https://www.ammk-rks.net/>. Gjithashtu, dispozita ligjore të shumta në lidhje me mbrojtjen e mjedisit mund të gjenden edhe ueb-sajtin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës: <https://mmphi.rks.gov.net/Document/Legislations>

⁴⁰ Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, i datës 23.06.2022.

⁴¹ Ligji Nr.03/L-043 Për Parandalimin dhe Kontrollimin e Integruar të Ndotjes, i datës 26.03.2009.

⁴² Ligji Nr.08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i datës 25.02.2010.

⁴³ Ligji Nr.03/L-233 Për Mbrojtjen e Natyrës, i datës 30.09.2010.

⁴⁴ Ligji Nr.08/L-181 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i datës 15.12.2022.

⁴⁵ Ligji Nr.04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, i datës 19.03.2013.

⁴⁶ Ligji Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet, i datës 22.07.2010.

Për t'u konsideruar se është kryer kjo formë e kësaj vepre penale, duhet që veprimet kryerëse të lartcekura të ndërmerren në kundërshtim me ligjet përkatëse.

Sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, shprehja **“mjedis”** ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshëm, që nënkupton rrethinën natyrore : ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

Andaj, edhe vepra penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, nga neni 338 të KPRK-së, është vepër penale e përgjithshme, në raport me veprat tjera penale të këtij Kapitulli.

“Ndotja e mjedisit”, sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, nënkupton ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut, kurse **“degradimi i mjedisit”** është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit, i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut, ndërsa **“dëmtimi i mjedisit”** është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore, të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, veprimet e kryerjes së veprës penale janë ndotja, degradimi ose shkatërrimi i ajrit, ujit ose tokës, kurse këto veprime kryerëse mund të kryhen në mënyra të ndryshme, por më së shpeshti në praktikë bëhet duke ndezur materie të rrezikshme me të cilat ndotet ajri; derdhja në ujë, lumenj apo liqene e materieve kimike të rrezikshme; duke shfrytëzuar jashtë mase burimet e ndryshme natyrore, eksploatimi jashtë mase i lumenjve, etj.

Është e rëndësishme që të theksohet se për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që ndotja, degradimi ose shkatërrimi të bëhet në përmasa të mëdha apo në sipërfaqe të gjera. Se kur konsiderohet se ndotja është kryer në përmasa të mëdha apo në sipërfaqe të gjera, kjo është çështje faktike dhe duhet të konstatohet në çdo rast konkret.⁴⁷

Mirëpo, një gjë e tillë sigurisht se më së miri do të mund të konstatohej përmes angazhimit të ekspertëve të fushës përkatëse. Kështu, Gjykata e Apelit të Kosovës, në një çështje penale, e kishte e aprovuar ankesën e paraqitur dhe kishte vendosur që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe lënda t'i kthehet në rigjykim kësaj gjykate. Sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës, në rigjykim, gjykata e shkallës së parë, fillimisht duhet që të angazhojë ekspertë të fushës përkatëse, në mënyrë që i njëjti të japë përgjigje se në rastin konkret me veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit, a është ndotur, degraduar apo shkatërruar mjedisi dhe pas sigurimit të ekspertizës, të caktojë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i administrojë të gjitha provat, ndërsa më pas të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.⁴⁸

⁴⁷ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014, f. 506.

⁴⁸ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1480/2022, i datës 21.12.2022.

Pasoja e kësaj forme të veprës penale konsiston në shkaktimin e rrezikut për mjedisin dhe jetën apo shëndetin e një numri të madh të njerëzve.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë në përgjithësi ajri, uji, toka ose burimet tjera natyrore.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1. të nenit 338 të KPRK-së, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Sikurse edhe shumë vepra tjera penale të parashikuara në pjesën e posaçme të KPRK-së, edhe kjo vepër penale ka format e saja të lehta dhe të rënda, përkatësisht më të rënda.

Në këtë aspekt, formë e lehtë e kësaj vepre penale, konsiderohet nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni është kryer nga pakujdesia, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose më burgim deri në një (1) vit.⁴⁹

Kurse, forma të rënda të kësaj vepre penale janë parashikuar në paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni, të cilat konsiderohet se ekzistojnë nëse veprat penale nga paragrafët 1. ose 2. i këtij neni rezultojnë :

- a) me dëmtimin e shëndetit të një të numri të madh të njerëzve;
- b) me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm;
- c) me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda apo
- d) me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike.

Për këto forma të rënda të kësaj vepre penale të kryera me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në pesë (5) vjet, ndërsa për këto forma të rënda të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në dy (2) vjet.

Në anën tjetër, formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafët 5. dhe 6. të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafët 1. ose 2. të këtij neni, rezulton:

- a) me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose
- b) me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore.

Për këto forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale të kryera me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim deri në tetë (8) vjet, ndërsa për këto forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.

Në fund, në paragrafin 7. të nenit të lartcekur, është parashikuar forma tjetër e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1. të këtij neni është kryer nga anëtar i grupit,⁵⁰ për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në katër (4) vjet.

⁴⁹ Neni 338, paragrafi 1. i KPRK-së.

⁵⁰ Sipas nenit 113, paragrafi 12. të KPRK-së, grup njerëzish konsiderohen tre (3) ose më shumë persona.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, ndërsa lidhur me formën e fajit, siç është theksuar edhe më lart, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje dhe nga pakujdesia.

4.1.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Edhe me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me Ligjin nr.44/2019, të datës 18.07.2019 është parashikuar si vepër penale *“Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës”*.

Sipas nenit 201 të KPRSH-së, ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet.

Nëse kjo vepër, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Kur kjo vepër ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

4.1.3. Disa raste nga praktika gjyqësore

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin A.D., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 21.05.2010, në orën e pacaktuar, në një fshat të komunës së Gjakovës, në kundërshtim me ligjin, **në furrat e gëlqeres ka bërë djegien e gomave të automjeteve nga të cilat lirohet tym i madh dhe në këtë mënyrë bën ndotjen e ambientit dhe shkakton rrezik për mjedisin, si dhe jetën dhe shëndetin e një numri të madh të njerëzve - banorë të këtij fshati.**⁵¹
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.N., pronar i thertores A.A., pasi që prej muajit Prill deri në muajin Gusht të vitit 2022, në intervale të ndryshme kohore, duke mos respektuar kushtet e parapara nenet 60 dhe 75 të Ligjit mbi Ujërat, ka bërë ndotjen e mjedisit, ashtu **që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë derdhjen e gjakut nga gjedhet e therrura në thertore, pa trajtim adekuat, në rrjedhjen e lumit të fshatit**

⁵¹ Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Gjakovë, P.nr.248/2010, i datës 16.07.2010.

Livoq i Epërm, kështu që i akuzuari me veprimet e veta ka bërë shkarkimin e ujërave nga impianti i thetores pa trajtim sipas kushteve të parapara me ligj, duke shkaktuar ndotjen e mjedisit, të konstatuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.⁵²

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin E.K. pasi në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe në kundërshtim me nenet 22, 23, 24, 25, 26 dhe 27 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për Minierat me Mineralet, bën ndotjen, degradimin dhe shkatërrimin të mjedisit dhe **shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore, në atë mënyrë që ushtron aktivitet të jashtëligjshëm, pa posedimin e lejes për aktivitete të veçanta minerare**, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, duke poseduar seperacionin me gurthyes statik të lëndës së parë minerare (të rërës dhe zhavorrit), eksploaton mineralet e rërës dhe të zhavorrit, me të cilat veprime krijon rrezik për ndotjen, degradimin dhe shkatërrimin e mjedisit.⁵³
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin sepse është konstatuar, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe Ligjit Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, **ka ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm, duke shfrytëzuar resurset minerale të gurit gëlqeror, në sasinë prej 939.20 m³, pa u pajisur me leje për aktivitet të veçantë me seperacion**, nga organi kompetent i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.⁵⁴
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin, sepse i njëjti nga pakujdesia kanë bërë ndotjen e ujit, **duke bërë shkarkimin e ujit në rrjedhën e lumit Lepenc, i cili gjendet afër fabrikës “S...” dhe uji ka rezultuar të jetë tejet i ndotur, duke tejkaluar vlerat e shkarkimit të ujit të tij**, gjatë punës në trup ujore, ku më datë 10.01.2020 nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës është përpiluar një raport dhe analizat fiziko – kimike të mostrës së ujërave të shkarkuar nga kjo kompani rezultojnë me tejkallim të disa parametrave kimik që tejkalon vlerat e shkarkimit të ujit.⁵⁵
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarit, pasi që me dashje ka shkelur Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke bërë ndotjen dhe degradimin e ujit dhe mjedisit në atë mënyrë që pas përpunimit të qumështit, pastrimit të kazanëve dhe larjes së makinave të prodhimit e në mungesë të impiantit industrial dhe pa pasur leje ujore, **ka hedh kundërligjshëm përmes ujërave shkarkues në oborrin e asaj fabrike mbetjet e artikujve ushqimor të qumështit, si**

⁵² Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, dega në Novobërdë, P.nr.57/2022, i datës 04.01.2023.

⁵³ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, nr.2023:088367, i datës 08.06.2023.

⁵⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, P.nr.291/2022, i datës 20.02.2023.

⁵⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, P.nr.187/2020, i datës 04.05.2022.

mbeturina industriale e me përmbajtje të rrezikshme, e të cilat mbetje kalojnë nga ato ujëra shkarkues në rrjedhën e ujërave pritës-përrocka-“AA” në Istog dhe pastaj në rrjedhën e Lumit Istog, e me ç’rast ato mbetje e ndotin kundërligjshëm mjedisin dhe ujërat e lartcekura si pjesë të mjedisit përmes përmbajtjes së lartë të materieve të rrezikshme të vajrave dhe vajrave dhe yndyrave, detergjenteve jo jonike, sulfateve dhe fosfateve duke tejkaluar vlerat referente në vlera të larta.⁵⁶

4.2. Mbjtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme (neni 339)

4.2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Mbjtja dhe administrimi i kundërligjshëm i substancave dhe mbeturinave të rrezikshme është parashikuar si veprë penale, duke e pasur parasysh rrezikun që mund të shkaktohet nga një aktivitet i tillë.

Substanca apo mbeturina të rrezikshme konsiderohen ato sende apo lëndë të cilat kanë veti apo elemente: helmuese, eksplozive, ndezëse, infektive, kancerogjene, që lirojnë gazra helmuese, etj.⁵⁷

Në nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Mbeturina⁵⁸ është parashikuar se **“mbeturina”** është substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh, kurse **“mbeturina të rrezikshme”** konsiderohen ato mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojca III (Lista H), në të cilën pjesë janë të paraqitura mbeturinat me elemente helmuese, eksplozive, ndezëse, infektive, kancerogjene, që lirojnë gazra helmuese, etj.

Është e rëndësishme që të theksohet se kjo veprë penale me këtë strukturë të veprimeve kryerëse është akceptuar nga Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit përmes të Drejtës Penale, pasi që një inkriminim i tillë i njëjtë është parashikuar edhe në nenet 2 dhe 3 të kësaj Konvente dhe i referohet si veprave penale të kryera me dashje, ashtu edhe atyre të kryera nga pakujdesia.

Formën themelore të kësaj veprë penale sipas paragrafit 1 të nenit 339 të KPRK-së, e kryen kushdo që duke shkelur ligjin, hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca të rrezikshme apo mbeturina që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë

⁵⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Istog, P.nr.337/2020, i datës 18.11.2022.

⁵⁷ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 507.

⁵⁸ Ligji nr.04/L-060 Për Mbeturina i datës 24.05.2012.

trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.

Veprimet kryerëse të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në:

- a) **hedhjen,**
- b) **trajtimin,**
- c) **depozitimin,**
- d) **transportimin,**
- e) **eksportimin ose**
- f) **importon substancave të rrezikshme apo mbeturinave që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial⁵⁹ material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.**

Për tu konsideruar se është kryer kjo formë e veprës penale duhet që veprimet kryerëse të ndërmerren në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, që do të thotë se kjo vepër penale, sikurse edhe veprat penale tjera të këtij Kapitulli është e karakterit blanket.

Kjo formë e kësaj vepre penale ka karakter të rrezikut abstrakt për jetën apo shëndetin e ndonjë personi apo dëmtimit substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë. Andaj, edhe si e tillë, kjo formë e kësaj vepre penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e ndërmarrjes së veprimit kryerës, pa qenë nevoja që të shkaktohet vdekja e ndonjë personi apo dëmtimi i shëndetit ose shkakimit të dëmtimit substancial të cilësisë së ajrit, tokës ujtit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.

Përndryshe, duhet të theksohet se jo çdo veprim në lidhje me substancat apo mbeturinat konsiderohet vepër penale, por vetëm në rastet kur substancat apo mbeturinat janë të rrezikshme dhe mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.

Përmes kësaj forme të veprës penale mbrohet jeta dhe shëndeti i njerëzve, mjedisi, përkatësisht ajri, toka, uji, kafshët, bimët dhe pasuria.

Sa i përket formës së fajit, kjo formë e kësaj vepre penale mund të kryhet me dashje dhe kryerës i saj mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar në mënyrë kumulative dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim prej një (1) deri në katër (4) vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 339 të KPRK-së është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila ekziston në rastet kur ndonjë person duke shkelur ligjin hedh, trajton, depoziton,

⁵⁹ Sipas nenit 113, paragrafi 33 të KPRK-së, dëm substancial konsiderohet humbje prej më shumë se pesëmbëdhjetëmijë (15.000) EURO deri në pesëdhjetëmijë (50.000) EURO.

transporton, eksporton ose importon substanca apo mbeturina radioaktive që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të njëjta sikurse forma themelore e kësaj vepre penale, por që ndërlidhet me substanca apo mbeturina radioaktive, të cilat konsiderohen më të rrezikshme në raport me substancat apo mbeturinat sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Për veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, kurse për veprën penale nga paragrafi 2. i këtij neni të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 5 të nenit të lartcekur, e cila ekziston nëse vepra nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Nëse vepra penale nga paragrafi 1 është kryer nga pakujdesia dhe ka rezultuar me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, atëherë është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

4.2.2. Veprat penale të kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Edhe me KPRSH të ndryshuar me ligjin nr.44/2019, e datës 18.07.2019, janë parashikuar disa vepra penale që ndërlidhen me menaxhimin e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme.

1) Kështu, në nenin 201/a të KPRSH-së është parashikuar vepra penale **“Menaxhimi i mbetjeve”**, veprimet kryerëse të së cilës janë të parashikuara në këtë mënyrë:

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2) Në nenin 201/b të KPRSH-së është parashikuar vepra penale **“Transportimi i mbetjeve”**.

Sipas kësaj dispozite ligjore, transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.

3) Kurse, në nenin 201/ç të KPRSH-së është parashikuar vepra penale **“Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”**.

Sipas kësaj dispozite ligjore, prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzet vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

4.3. Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit (neni 341)

Dëmtimi i objekteve dhe i pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit është një vepër e re penale që është parashikuar në nenin 341 të KPRK-së⁶⁰ dhe arsye pse është parashikuar një vepër e tillë penale në legjislacionin tonë qëndron në atë se tani më janë instaluar dhe shfrytëzohen objekte dhe pajisje të tilla për mbrojtjen e mjedisit.

⁶⁰ ADEMI, BURIM; SHALA, AFRIM; MEHMETI, AVNI, Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), f. 272.

Sipas paragrafit 1 të këtij neni, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që i dëmton, shkatërron, heq apo në mënyrë tjetër i bënë të papërdorshme objektet apo pajisjet për mbrojtjen e mjedisit.⁶¹

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në:

- a) **dëmtimin,**
- b) **shkatërrimin,**
- c) **heqjen ose**
- d) **bërjen në ndonjë mënyrë tjetër të papërdorshme të objekteve ose pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit.**

Siç është theksuar edhe më parë, sipas nenit 4 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, shprehja “**mjedis**” ka një domethënie të gjerë dhe të përgjithshëm, që nënkupton rrethinën natyrore: ajrin, tokën, ujin, klimën, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore, si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

Objekt i veprimit të kësaj vepre penale janë objektet apo pajisjet e instaluara që shërbejnë për mbrojtjen e mjedisit.

Për këtë formë të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

Formë e lehtë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia dhe për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 341 të KPRK-së, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet, nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territor të gjerë. Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet, ndërsa për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

⁶¹ Pajisjet për mbrojtjen e mjedisit janë të mbrojtura edhe me një vepër penale tjetër. Kështu, me nenin 357 të KPRK-së është parashikuar si vepër penale “*Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike*”. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, “*Kushdo që asgjëson, dëmton apo i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit, naftës-jellësve, kabllave nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme dhe me këtë shkakton çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë, dënohet me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Ndërsa, formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni, e cila konsiderohet se është kryer nëse si rezultat i kësaj vepre penale është bërë asgjësimi i plotë ose i pjesërishtëm i botës shtazore, bimore ose ndotja është bërë në shkallë të madhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar. Për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, ndërsa për këtë formë edhe më të rëndë të kësaj vepre penale të kryer nga pakujdesia është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.

Në paragrafin 7 të këtij neni, është parashikuar se kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmerr masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

4.4. Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve (neni 342)

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 342 të KPRK-së, e kryen kushdo që prodhon me qëllim që t'i shesë apo t'i vë në qarkullim materiet për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve, kur materiet e tilla janë të dëmshme për jetën apo për shëndetin e tyre.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në **prodhimin me qëllim shitje ose vënie në qarkullim të materieve të dëmshme për mjekimin apo parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve.**⁶²

Me shprehjen “prodhimi i materieve për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve“ nënkuptohet tërë procesi apo një pjesë e procesit farmaceutik teknologjik të sajimit të barit apo të shtesave të barit, si dhe përpunimi teknologjik dhe verifikimi i cilësisë dhe depozitimi e dërgimi i tij tek konsumatori.

Ndërsa, shprehja “vënia në qarkullim“ duhet nënkuptuar mundësimin e shfrytëzuesve që t'i blejnë materiet e këtilla, përkatësisht kur materiet e këtilla shiten me pakicë ose me shumicë.⁶³

Kjo formë e kësaj vepre penale është e karakterit të rrezikut abstrakt, ngase konsiderohet se është kryer me vetë faktin e prodhimit me qëllim të vënies në qarkullim të materieve të dëmshme për mjekimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve. Pra, forma themelore e kësaj vepre penale ekziston edhe pse nuk është dëmtuar shëndeti i kafshëve apo i shpendëve apo ngordhja e tyre.

⁶² SHALA, AFRIM, Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Revista “Avokatura”, nr. 14, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 15-31.

⁶³ SALIHU, ISMET, E drejta penale, Pjesa e posaçme, f. 513.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpendëve.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe burgim prej tre (3) muajve deri në tre (3) vjet.

Në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, kurse në paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar se nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4.5. Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinarë (neni 344)

Ushtrimi i shërbimeve veterinarë duhet të bëhet nga personat profesionist dhe që posedojnë përgatitje adekuate. Kjo për faktin se ushtrimi i kësaj veprimtarie nga persona të pakualifikuar dhe që nuk posedojnë përgatitje adekuate përbën rrezik për shëndetin e shtazëve. Për këtë arsye, ushtrimi i shërbimeve veterinarë nga personat që nuk posedojnë përgatitje adekuate përbën vepër penale sipas KPRK-së.⁶⁴

Sipas nenit 344 të KPRK-së, këtë vepër penale e kryen kushdo që pa përgatitje adekuate profesionale merret me shërimin e shtazëve ose ofron shërbime tjera veterinarë në kompensim të pagesës.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale konsistojnë në:

- a) **Marrjen me shërimin e shtazëve ose**
- b) **Ofrimin e shërbimeve tjera veterinarë.**

Elementet e kësaj vepre penale janë:

- a) **Marrja me shërimin e shtazëve ose ofrimin e shërbimeve tjera veterinarë;**
- b) **Që kryesi të mos ketë përgatitje adekuate profesionale;**
- c) **Që veprimet kryerëse të lartcekura të ndërmerren në kompensim të pagesës.**
- d) **Që veprimet e lartcekura të ndërmerren me dashje.**

⁶⁴ ADEMI, BURIM; SHALA, AFRIM; MEHMETI, AVNI, Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, f. 274.

Siç shihet, kjo vepër penale ka karakter blanket, ngase me Ligjin për veterinarinë⁶⁵ është rregulluar në mënyrë më të hollësishme ushtrimi i veprimtarisë veterinare dhe kushtet të cilat duhet t'i përmbushin personat për ta ushtruar një veprimtari të tillë.

Kështu, në nenin 32, paragrafi 2 të këtij Ligji, është parashikuar se profesionin e veterinarisë mund ta ushtrojnë personat të cilët posedojnë licencën të lëshuar nga Ministria dhe të jenë të regjistruar në Regjistrin e Veterinerëve. Ndërsa, në nenin 32, paragrafi 3 të këtij Ligji, është parashikuar se licencat u jepen vetëm aplikantëve të cilët kanë diplomuar në medicinën dhe kirurgjinë veterinare dhe kanë diplomën ose kualifikimin formal superior.

Për të ekzistuar kjo vepër penale, duhet që ushtrimi i shërbimeve të lartcekura veterinare të bëhet në kompensim të pagesës, edhe pse konsiderojmë se ushtrimi i këtyre shërbimeve veterinare është dashur që të inkriminohet, pavarësisht faktit nëse është bërë me kompensim të pagesës apo pa pagesë.

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e ushtrimit të kësaj veprimtarie, edhe pse nuk është shkaktuar kurrfarë pasojë.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryes i saj mund të jetë çdo person.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

4.6. Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve (neni 345)

4.6.1. Shqyrtime të përgjithshme

Vepra penale moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve, bën pjesë në grupin e veprave penale që kryhen me mosveprim, të cilat në teorinë e së drejtës penale ndryshe quhen edhe si *“delikte omisive”*,⁶⁶ pasi që kryesi nuk e ndërmer veprimin të cilin ka qenë i obliguar që të ndërmerr.

Sipas paragrafit 1 të nenit 345 të KPRK-së, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin, me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes.

⁶⁵ Ligji Nr.2004/21 Për Veterinarinë, i datës 16.06.2004.

⁶⁶ SHALA, AFRIM, Hyrje në të drejtën penale, f. 51.

Shprehja “blegtori”, sipas paragrafit 6 të këtij neni, do të thotë çdo gjedh, bricjap, kalë, zog, shpezë, shpendë, bletë mjalti, dele, derr apo peshk.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale manifestohet **në mosrespektimin e urdhrin apo vendimit të lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin, me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes.**

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm gjatë kohës së ndonjë epidemie e cila mund të rrezikojë blegtorinë, andaj edhe kohëzgjatja e ndonjë epidemie është tipar themelor i kësaj vepre penale.

Kjo formë e kësaj vepre penale sipas paragrafit 1 të këtij neni është e karakterit të rrezikut abstrakt dhe konsiderohet që është kryer me vetë faktin e mos respektimit të urdhrin apo vendimit të lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin, me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Formë tjetër e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse ndokush gjatë periudhës së rrezikut ndaj botës bimore nga sëmundja ose murtaja, nuk respekton urdhrin apo vendimin e organit kompetent me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes ose të murtajës.

Edhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, atëherë kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëm të konsiderueshëm pasuror.⁶⁷ Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Nëse kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale është kryer nga pakujdesia, atëherë kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4.6.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

⁶⁷ Sipas neni 113 të KPRK-së, “Dëm i konsiderueshëm” nënkupton çdo humbje prej më shumë se pesëmijë (5.000) euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro.

Me KPRSH është parashikuar si vepër penale *“Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve”*. Kështu, në nenin 207 të KPRSH-së është parashikuar se shkelja e rregullave për karantinën⁶⁸ e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasojat të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

4.7. Shkretërimi i pyjeve (neni 348)

4.7.1. Shqyrtime të përgjithshme

Pyjet kanë një rëndësi të madhe për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja.

Pyjet konsiderohen resurse kombëtare dhe gëzojnë mbrojtje të posaçme jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Sipas statistikave të disa organizatave, pyjet i mbulojnë afro 40% të mbarë territorit të Kosovës, ku prej tyre 60 % janë pronë publike, kurse 40% janë pronë private. Shkatërimi, dëmtimi dhe vjedhja e pyjeve në Kosovë është duke u bërë në përmasa të mëdha, sidomos këto vitet e fundit.⁶⁹ Andaj, me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie, si në legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore, ashtu edhe në KPRK, janë parashikuar si vepra penale shkretërimi dhe vjedhja e pyjeve.

Kështu, sipas nenit 348, paragrafi 1 të KPRK-së, veprën penale të shkretërimit të pyjeve e kryen kushdo që në kundërshtim me ligjin ose me urdhrin e organit kompetent bën prerjen ose shkatërimin e pyllit ose në ndonjë mënyrë tjetër shkretëron pyjet.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë:

- a) në prerjen e pyllit,**
- b) shkretërimin e pyllit ose**
- c) shkretërimin e pyjeve në ndonjë mënyrë tjetër.**

Për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet që veprimet e kryerjes të jenë ndërmarrë në kundërshtim me ligjin apo në kundërshtim me urdhrin e organit kompetent. Nga kjo shihet se kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me ligje të posaçme janë rregulluar çështjet e mbrojtjes së pyjeve dhe kur konsiderohen se janë dëmtuar apo shkatërruar pyjet. Pyjet në Kosovë janë të mbrojtura dhe të rregullura edhe me Ligjin për Pyjet.⁷⁰

⁶⁸ Në nenin 2, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 105/2016 për Mbrojtjen e Bimëve (ndryshuar me ligjin nr. 15/2022, datë 3.2.2022) është parashikuar se *“Karantinë bimore”* është tërësia e masave parandaluese, të marra me qëllim parandalimin e hyrjes dhe/ose përhapjes së një dëmtuesi karantinor.

⁶⁹ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 259.

⁷⁰ Ligji Nr.08/L-137 Për Pyjet, i datës 09.03.2023.

Organ kompetent në sensin e kësaj vepre penale, duke u bazuar në Ligjin për Pyjet, konsiderohet Agjencia Pyjore e Kosovës, e cila i ka zyret e saj në të gjitha regjionet e Kosovës.⁷¹

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë pyjet e Kosovës.

Sipas nenit 4 të Ligjit për Pyjet, “**Pyll**” është sipërfaqja e mbuluar me drunj pyjor, më të lartë se pesë (5) metra në fazën e tyre të pjekurisë, në formë të grumbullit pyjor ose grupeve të vogla të drunjëve, me kurorë dendësi më të madhe se 10%, e cila gjithashtu përfshinë bashkësinë biekologjike, që është më e madhe se 50 ari.

Nëse mirret për bazë pronësia e pyjeve, pyjet në Kosovë ndahen në pyje publike dhe pyje private.

“**Pyjet publike**” janë pyjet dhe tokat pyjore në pronësi shtetërore, kurse “**Pyjet private**” janë pyjet dhe tokat pyjore në pronësi të personit fizik apo juridik.⁷²

Funksionet e pyjeve janë:

- 1. Ekonomike dhe prodhuese** që kanë të bëjnë me prodhimin e drurit dhe produkteve jo drunore;
- 2. Ekologjike** që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tokës pyjore, regjimin e ujërave, ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike - përfshirë habitatet dhe llojet e florës dhe faunës së egër, resurseve gjenetike, sekuestrimi i karbonit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe
- 3. Sociale** që kanë të bëjnë me rekreacionin, pushimin, turizmin, gjuetinë, edukimin, shëndetësinë dhe hulumtimet pyjore.⁷³

Në nenin 3, paragrafi 1.26. të Ligjit për Pyjet është parashikuar se “**Shkretërimi i pyjeve**” nënkupton çdo veprim me të cilin dobësohet plleshmëria e tokës pyjore, pamundësohet prodhimtaria ose qëndrueshmëria e pyjeve, realizimi i funksioneve pyjore dhe çdo veprim tjetër që mund të sjellë bimësi të padëshiruara, erozion, shpërlarje dhe rrëshqitje të dheut.

Vepra penale e shkretërimit të pyjeve mund të kyhet si në pyjet publike, ashtu edhe në pyjet private.

Është e rëndësishme që të theksohet se këtë vepër penale mund ta kryejë edhe pronari në pyllin e vet, p.sh. nëse bën prerjen apo shkatërrimin e pyllit të tij, në kundërshtim me ligjin ose në kundërshtim me urdhrin e Agjencisë Pyjore të Kosovës, nëse bën hapjen e rraheve apo rrugëve, në kundërshtim me Ligjin e Pyjeve, nëse bën zhveshjen e trungjeve, etj.

Vepra penale konsiderohet se është kryer në rastet kur është shkaktuar shkretërimi i pyjeve.

⁷¹ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 259.

⁷² Neni 3, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.21. dhe 1.31. të Ligjit për Pyjet.

⁷³ Neni 5 i Ligjit për Pyjet.

Për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

Në paragrafin 2 të nenit 348 të KPRK-së, është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet

- a) në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm ose
- b) kur kryesi vepron si anëtar i grupit.

Për këtë formë të rëndë kësaj vepre penale sipas paragrafit 2 është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Vepra penale e shkretërimit të pyjeve, mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

4.7.2. Veprat penale të kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Në KPRSH janë parashikuar katër (4) vepra penale (kundërvajtje penale) të kësaj natyre, ku objekt mbrojtës janë pyjet.

1) Në nenin 205 të KPRSH-së është parashikuar si kundërvajtje penale ***“Prerja e paligjshme e pyjeve”***.

Kështu, sipas kësaj dispozite ligjore, prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

2) Në nenin 206 të KPRSH-së është parashikuar si kundërvajtje penale ***“Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë”***.

Sipas kësaj dispozite ligjore, prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.

3) Në nenin 206/a të KPRSH-së është parashikuar si vepër penale ***“Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”***.

Sipas kësaj dispozite ligjore, shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

4) Në nenin 206/b të KPRSH-së është parashikuar si vepër penale **“Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor”**.

Sipas kësaj dispozite ligjore, shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet

4.7.3. Disa raste nga praktika gjyqësore

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin J.H., sepse më datë 22.10.2021, rreth orës 13:10, në vendin mbi fshatin SH., Istog në Rajonin Pyjor Radushë, **në pyllin e tij privat në kundërshtim me urdhrin e organit kompetent ka bërë shkatërrimin e pyllit, duke bërë prerjen e drunjtëve dhe atë pa leje dhe pa damkosje e duke shkretëruar pyjet**, në atë mënyrë që: në datë dhe në vendin e lartfcekur me sharrë motorike në pronën private-në bashkëpronësi të prindit të tij –ngastrën kadastrale nr. 00087-111 ZK SH/Istog, ka prerë drunjtë e llojit *“Ahu”*, në gjatësi prej 1 metër me diametër prej 10-60 cm, e në vëllim prej tre (3) m³ dhe atë pa leje për prerje, pa damkë pyjore dhe pa fletë përcjellje të lëshuar nga organi kompetent, ku ishte hasur nga policia duke i transportuar drunjtë e prerë me traktorin e tij të markës *“IMK Rakovica”* me ngjyrë të kaltër.⁷⁴
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.M., sepse më datë 20.06.2019, rreth orës 11:00 minuta ne rr.”..” në fshatin ... në parkun e mbrojtur “...” , e cila është nën administrimin e DAPK-së dhe atë në kundërshtim me ligjin dhe pa leje të organit kompetent bën prerjen e pyllit në vendin e lartcekur në pronë e tij private parcelën 169/1, ku nga zyrtaret e DAPK-së konstatohet se i njëjti ka prerë masën drunore të llojit *“Breu”*, 48 copë me vëllim të përgjithshëm 40.937 m³.⁷⁵
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.R., sepse më datë 16.03.2019, rreth orës 16:30, në fshatin R., Komuna e P., i akuzuari me qëllim të shkretërimit të pyllit shoqëror, ka shkuar me kombi të markës *“VW”*, ngjyrë të bardhë me tabela të

⁷⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Istog, P.nr.358/2021, i datës 24.11.2022.

⁷⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.193/2020, i datës 08.09.2020.

regjistrimit ..., në pyllin në fshatin R. dhe nga aty ka nxjerr me rrajë dhe i ka vendosur në kombi 104 fidanë të llojit "Pishe".⁷⁶

- Gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit R.D. dhe F.D., sepse datë 18.04.2018, në kohë të pacaktuar, në fshatin ..., pikërisht në ngastrën kadastrale nr.47-0 dhe 256-0, me kulturë mal, në vendin e quajtur "... "e evidentuar në fletën posedues me nr.30 si pronë shoqërore - e mirë e fsh.ZK-V, e cila menaxhohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, **kanë bërë shkatërrimin e pyjeve, duke prerë dhe duke bërë zhveshjen e trungjeve, në mënyrë ilegale, pa kontratë dhe pa pëlqim nga Agjencioni Pyjor i Kosovës.**⁷⁷

4.8. Vjedhja e pyllit (neni 349)

4.8.1. Shqyrtime të përgjithshme

Sipas paragrafit 1 të nenit 349 të KPRK-së, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e drunjve të prerë tejkalon dy metra kub.

Për nga natyra e saj, vepra penale e vjedhjes së pyllit është formë e posaçme e vjedhjes dhe për këtë shkak nuk mund të bëhet fjalë për bashkimin ideal të kësaj vepre me veprën penale të vjedhjes.⁷⁸

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në prerjen e trungjeve.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale, prerja e trungjeve duhet të bëhet me qëllim të vjedhjes së tyre, respektivisht me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme. Nga kjo rrjedh se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm në pyllin e huaj. Në të kundërtën, nëse kryesi bën prerjen e trungjeve në pyllin e vet, në kundërshtim me ligjin ose urdhrin e organit kompetent, atëherë në këto raste mund të bëhet fjalë për veprën penale të shkatërrimit të pyjeve, nga neni 348 të KPRK-së.

Gjithashtu, siç është cekur edhe në paragrafin 1 të nenit 349 të KPRK-së, për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet që sasia e drunjve të jetë mbi 2 m³ (dy metra kub). Nëse sasia e drunjve është më e vogël se 2 m³ (dy metra kub), atëherë mund të bëhet fjalë për kundërvajtje.

Vepra penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e prerjes së trungjeve.

Për formën themelore të kësaj vepre penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

⁷⁶ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, P.nr.418/2019, i datës 22.10.2019.

⁷⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Istog, P.nr.158/2019, i datës 02.09.2019.

⁷⁸ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 261.

Forma e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 349 të KPRK-së, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në këto rrethana :

- me qëllim që drunjtë e prerë të shiten ose
- nëse sasia e drunjve të prerë është mbi pesë (5) metra kub.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre muajve deri në katër (4) vjet.

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila ekziston nëse vepra penale nga ky nen kryhet:

- në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm;
- me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete ose për ndonjë person tjetër.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Sipas paragrafit 4 të nenit të lartcekur, tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

4.8.2. Disa raste nga praktika gjyqësore

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin L.S., sepse më datën 03.07.2022, rreth orës 21:30 minuta, në pyllin e pronës shtetërore, në paralelen nr.24 dhe 25, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për veti, me dashje, me sharrë motorike, në ngastrën 24, ka prerë 90 copë trungje të njoma, të llojit bung, me diametër në cung 20-46 cm, me vëllim të përgjithshëm 6.03m³ dhe në ngastrën 25 ka prerë 5 copë trungje të njoma, të llojit “Ahu”, me diametër në cung 36-46, me vëllim të përgjithshëm 4.39m³, ku vëllimi i përgjithshëm prej 10.42 m³, të cilat i ka bartur me traktor të markës “Rakovica” me rimorkio të adaptuar dhe me ramë, në këtë mënyrë të dëmtuarës APK-së, zyra në Kamenicë, i ka shkaktuar dëm material në shumën të pa përcaktuar.⁷⁹
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin S.M., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 06.07.2007, në territorin e një fshati të Komunës së Gjilanit, në vendin e quajtur “Llaqinov”, me qëllim vjedhje në pyllin e pronësisë publike, me sharrë motorike ka prerë 20 trungje bungu, me diameter 20-25 cm, me lartësi 8 metra, me

⁷⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Kamenicë, P.nr.161/2022, i datës 25.09.2023.

vëllim të përgjithshëm prej 3.82 m³, duke e dëmtuar me këtë Agjencionin e Pyjeve të Kosovës, në vlerë prej 153.80 Euro.⁸⁰

- Gjykata e ka shpallur fajtori të akuzuarin E.S., sepse, me datë 21.09.2021, rreth orës 11:30, në territorin e fshtatit “S”, komuna e Vitisë, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur “...”, me qëllim vjedhje, me sharrë motorrike ka prerë 24 copa drunjë të llojit “*Ahu-shkozë*”, me diametër në cung 16-19 cm, në lartësi të drurit 17 cm, me vëllim të përgjithshëm 2.88 m³, në këtë mënyrë të dëmtuarës AKP në Viti i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 389.00 Euro.⁸¹

4.9. Gjuetia e kundërligjshme (neni 350)

4.9.1. Shqyrtime të përgjithshme

Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të nenit 350 të KPRK-së, e kryen kushdo që gjuan kafshë të egra, kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar.

Veprimet e kryerjes të kësaj forme të veprës penale konsistojnë në:

- **gjuajtjen e kafshëve të egra gjatë kohës kur gjuetia është e ndaluar ose**
- **gjuajtjen e kafshëve të egra në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar.**

Veprimi në formën e parë ka të bëjë me kohën e kryerjes së gjuetisë, kurse veprimi i dytë ka të bëjë me vendin e kryerjes së gjuetisë.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose më burgim deri në një (1) vit.

Në paragrafin 2 të nenit 350 të KPRK-së, është parashikuar një formë tjetër e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush pa leje ose autorizim, gjuan ose mbytt një kafshë të egër ose e zë të gjallë.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në:

- **gjuajten e një kafshe të egër,**
- **mbytjen e një kafshe të egër ose**
- **zënja (kapja) për së gjalli e një kafshe të egër.**

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë kafshët e egra.

⁸⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan, P.nr.840/2007, i datës 18.08.2008.

⁸¹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti, P.nr.157/2022, i datës 04.07.2023.

Sipas nenit 3 të Ligjit për gjuetinë,⁸² shprehja “**Kafshë të egra**” përfshinë kafshët dhe shpendët e egra të caktuara me ligj, që formojnë popullata në gjendje të lirë në natyrë ose në sipërfaqe të kufizuara të parapara për kultivim intensiv apo për shumim.

Kafshë të egra sipas nenit 4 të këtij ligji, konsiderohen : dreri i rëndomtë, dreri lopatar, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, ariu i murmë, lepuri i zakonshëm, ketri, dhelpra, ujku, çakalli, macja e egër, pula e egër e madhe, fazani, pëllumbi gungash, pëllumbi i zgavrave, pëllumbi i zi, pata e përhimtë, pata e murrizit, pata ballbardhë, rosa shurdhake, rosa e përhimt, rosa, kukuvajka e bardhë, huti veshor i pyjeve, huti i maleve, sokoli pulngrënës, orli, etj.⁸³

Për ekzistimin e veprës penale sipas paragrafit 2 të nenit 350 të KPRK-së, duhet që gjuetia e kafshëve të egra të bëhet pa leje ose pa autorizim.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 350 të KPRK-së. Sipas kësaj dispozite ligjore, kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet:

- jashtë sezonës;
- në grup;⁸⁴
- ndaj gjahut në vlerë që tejkalon 2000 (dymijë) Euro ose
- me rëndësi sipas rregulloreve të gjuetisë.

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Ndërsa, në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 359 të KPRK-së, janë parashikuar forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale, të cilat konsiderohet se kryhen nëse ndokush :

- gjuan lloje të rrezikuara ose të rralla të kafshëve, gjuetia e të cilave është e ndaluar;
- gjuan lloje të posaçme pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu;
- gjuan duke përdorur metoda të asgjësimit masiv;
- duke përdorur automjetin ose
- duke përdorur dritën e fortë.

Për këto forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale, është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar se kafshët e egra dhe pajisjet e gjuetisë konfiskohen.

⁸² Ligji Nr.02/L-53 Për Gjuetinë, i datës 16.12.2005.

⁸³ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 264.

⁸⁴ Sipas nenit 113, paragrafi 12. të KPRK-së, grup njerëzish konsiderohen tre (3) ose më shumë persona.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

4.9.2. Disa raste nga praktika gjyqësore

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin I.B., sepse më datë 26.11.2022, rreth orës 11:05, në fshatin S....., komuna e Gjilanit, **me dashje, ka gjuajtur kafshë të egra në kohën kur gjuetia është e ndaluar**, në atë mënyrë që në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 8.1 të Ligjit për Gjuetinë me nr. 02/L-53, me përdorimin pushkës së gjuetisë të llojit “*Over & Under Zastava*” nr. Serik 37825 **ka vrarë tre (3) kafshë - derra të egër, në zonën ku gjuetia ka qenë e ndaluar në atë ditë.**⁸⁵
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.M., për shkak të kësaj vepre penale, sepse më datën 29.10.2004, rreth orës 9:30 minuta, në pyllin afër një fshati në Gjilan, me pushkën e tij të gjuetisë, të prodhimit turk, me kalibër 12 mm, **ka dalë në gjah dhe ka gjuajtur kafshë të egra, pa autorizim në kohën kur ka qenë ndalesa për gjuajtjen e kafshëve të egra**, e cila është në kundërshtim me rregullat e gjuetisë.⁸⁶
- Gjykata i ka shpallur fajtor të akuzuarit V.E. dhe S.O., për shkak të kësaj vepre penale, sepse të akuzuarit më datën 29.12.2007, në një fshat të komunës së Kamenicës, **pa leje kanë dalur në gjueti të kafshëve të egra, në atë mënyrë që paraprakisht i lëshojnë zagarët e tyre për t’i ndjekur kaprojtë, kurse të akuzuarit nga pozicionet që ishin vendosur më parë, me pushkët e tyre të gjuetisë arrijnë që t’i vrasin dy (2) kaproj.**⁸⁷
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin Q.K., sepse më datë 26.09.2020, rreth orës 20:30, në fshatin Gorancë, komuna Hani i Elezit, përkatësisht tek vendi i quajtur “Zheden”, ka përdorur pushkën e gjuetisë të markës “Arsman”, me numër serik , kalibër 12 mm, **në atë mënyrë që ka shtënë tre (3) herë në drejtim të një lepuri të cilin e qëllon dhe e mbyt.**⁸⁸
- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.T., sepse më datë 12.01.2017 rreth orës 18:20 minuta, në fshatin M., komuna e Suharekës, **pa leje ose autorizim, mbyt kafshët të egra, në atë mënyrë që me pushkë gjysëm automaktike gjuan dhe i mbyt dy derra të egër.**⁸⁹

⁸⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.1249/2022, i datës 06.07.2023.

⁸⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr.191/2004, i datës 02.02.2005.

⁸⁷ Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë, P.nr.18/2008, i datës 07.05.2008.

⁸⁸ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.154/2020, i datës 16.12.2020.

⁸⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë, P.nr.487/2017, i datës 31.07.2018.

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin P.N., sepse më datë 05.01.2018, rreth orës 11:20 minuta, mbi fshatin, komuna e, me armën e tij të gjuetisë ... me numër ..., me 17 fishekë, **gjuan kafshë të egëra, ku gjuetia në vendin - territorin e lartcekur është e ndaluar, me të cilin rast gjatë patrullimit nga ana e policisë është hasur duke zhvilluar aktivitete ilegale të gjuetisë.**⁹⁰

4.10. Peshkimi i kundërligjshëm (neni 353)

4.10.1. Shqyrtime të përgjithshme

Sipas paragrafit 1 të nenit 353 të KPRK-së, formën themelore të kësaj vepre penale e kryen kushdo që peshkon gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar.

Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsistojnë në:

- **peshkimin gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo**
- **peshkimi në ujërat ku peshkimi është i ndaluar.**

Shprehja **”peshkim”**, sipas nenit 3 të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë⁹¹ nënkupton çdo veprimtari për gjuajtjen e peshkut dhe organizmave tjerë ujorë, duke përdorur mjete dhe pajisje të ndryshme.

Po sipas kësaj dispozite ligjore:

”Ujërat e peshkimit” janë ujërat e lumenjve, proçkave, liqeve natyral dhe artificial, kënetave, kanaleve dhe ujërave tjera në të cilat jetojnë peshqit, ndërsa **”Organizma ujor”** janë organizmat e gjallë shtazorë dhe bimor të ngrënshëm ose të pangrënshëm që kanë ujin si mjedis jetësor e ku përfshihen peshqit, gaforret, molusqet, ushejzat, bretkosat dhe gjallesat tjera ujore.

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit 353 të KPRK-së, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese dhe me këtë shkakton ngordhjen e peshqve në mënyrë të tillë që të dëmtojë shumimin e peshqve.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston në peshkimin duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese.

⁹⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.298/2018, i datës 08.04.2019.

⁹¹ Ligji Nr.02/L-85 Për Peshkatari dhe Akuakulturë, i datës 10.10.2006.

Siç shihet, kjo veprë penale kryhet duke përdorur mjetet e caktuara ose duke peshkuar në mënyrë të dëmshme për shumimin e peshqve. Mjete të kryerjes së kësaj veprë penale janë eksplozivi, rryma elektrike, helmet ose mjetet helmuese.⁹²

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm në ujërat e peshkimit. Siç është theksuar edhe më parë, sipas nenit 3 të Ligjit për peshkatari dhe akuakulturë, shprehja **”ujërat e peshkimit”** nënkupton ujërat e lumenjve, prockave, liqeve natyralë dhe artificialë, kënetave, kanaleve dhe ujërave tjera në të cilat jetojnë peshqit.

Vepra penale e peshkimit të kundërligjshëm, mund të kryhet vetëm me dashje dhe kryes i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Për këtë formë të rëndë të kësaj veprë penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

4.10.2. Vepra penale e kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

Në nenin 204 të KPRSH-së është parashikuar si kundërvajtje penale **“Peshkimi i ndaluar”**.

Sipas kësaj dispozite ligjore, peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

4.10.3. Disa raste nga praktika gjyqësore

- Gjykata e ka shpallur fajtor L.S. sepse më datë 09.07.2021, rreth orës 08:20 minuta, në lumin “.....” në fshatin V....., komuna e Prizrenit, vepron në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr.02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, në atë mënyrë që peshkon në mënyrë të kundërligjshme gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar dhe pa leje të peshkimit, ashtu që **në vendin e lartcekur peshkon, duke i hedhur tri (3) rrjeta të peshkimit me gjatësi prej 150 metra, duke kapur peshk të llojit “Saraga” (Gilica) katër (4) kg dhe dy (2) peshqi të llojit “Sharan” (Krap) me peshë prej gjashtë (6) kg**, me ç’rast policia me të vërejtur veturën e markës dhe tipit “.....ngjyrë e kaltër, me targae ndalon tek vendi i quajtur “Mulliri i vjetër” pranë lumit në V..... dhe se pas kontrollit në veturën e të akuzuarit janë gjetur rrjeta të peshkimit dhe dy korita të zeza të mbushura me peshk, me ç’rast edhe kapet nga ana e policisë kufitare.⁹³

⁹² ADEMI, BURIM; SHALA, AFRIM; MEHMETI, AVNI, Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), f. 281.

⁹³ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.809/2021, i datës 05.05.2022.

- Gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarit A.K. dhe F.S., sepse më datë 11.04.2020, rreth orës 13:00, në lumin "Drini i Bardhë", në fshatin Vërmicë, komuna e Prizrenit, vepron në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr. 02/L-85 për Peshkatari dhe Akuakulturë, në atë mënyrë peshkojnë në mënyrë të kundërligjshme, gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar dhe pa leje të peshkimit, ashtu që në vendin e lartcekur peshkojnë duke i hedhur dy rrjeta të peshkimit, duke kapur tre (3) copë peshqi në peshë prej pesë (5) kg, me ç'rast me të vërejtur policinë që po shkonte në drejtim të tyre, të pandehurit tentojnë që t'i fshehin rrjetat duke i futur nën Kamionetën e tipit "Daimler Benz".⁹⁴

4.11. Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 354)

4.11.1. Shqyrtime të përgjithshme

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale janë monumentet dhe objektet e mbrojtura kulturore, historike, fetare, shkencore apo natyrore.

Sipas paragrafit 5 të nenit 354 të KPRK-së, shprehja "**monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror**" do të thotë objekt nderimi i një komuniteti fetar i cili ndodhet në pronën e caktuar për shërbime fetare, gur varri, varr apo vend tjetër i varrimit, monument publik, monument natyror, objekt artistik, shkencor apo artizanat i cili ruhet në koleksione publike ose në ekspozita publike, objekt i cili shërben për ndonjë nevojë publike ose zbukuron rrugën publike, sheshin apo parkun, atraksion natyror apo një lloj të rrezikuar i kafshëve ose bimëve.

Formën themelore të kësaj vepre penale nga paragrafi 1 i këtij neni, e kryen kushdo që e dëmton ose e shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Për nga natyra dhe përmbajtja e saj, edhe kjo vepër penale është e karakterit blanket, ngase me dispozita të posaçme është rregulluar pozita dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me monumentet dhe objektet e mbrojtura.

Dispozita ligjore të kësaj natyre gjenden edhe në Ligjin për trashëgiminë kulturore⁹⁵ dhe disa ligje tjera.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është i përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiston:

⁹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.532/2020, i datës 13.04.2021.

⁹⁵ Ligjin Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, i datës 09.10.2006.

- a) **Dëmtimin e monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror ose**
- b) **Shkatërrimin e monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.**

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Në paragrafin 2 të këtij neni, është parashikuar formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj **monumentit ose objektit të mbrojtur** kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror që kanë vlerë të posaçme ose **nëse vepra penale rezulton me dëm të rëndë.**

Për këtë formë të rëndë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Formë e posaçme e kësaj vepre penale, është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush pa autorizimin përkatës të organit kompetent **nxjerrë jashtë Republikës së Kosovës** monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiston në nxjerrjen jashtë Republikës së Kosovës të monumentit, ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror.

Për ekzistimin e kësaj forme të veprës penale, duhet që veprimi i kryerjes të ndërmirret pa autorizimin përkatës të organit kompetent.⁹⁶

Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

Formë e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar edhe në paragrafin 4 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni ka të bëjë me monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme, për të cilën është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar se tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni është e dënueshme.

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person dhe kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

⁹⁶ SHALA, AFRIM, Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, f. 267.

4.11.2. Veprat penale të kësaj natyre sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

1) Në nenin 166 të KPRSH-së është parashikuar si vepër penale ***“Shkatërrimi i veprave kulturore”***.

Sipas kësaj dispozite ligjore, shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i veprave kulturore dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Kur nga vepra penale janë shkatërruar apo dëmtuar vepra kulturore me rëndësi kombëtare, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy gjer në tetë vjet.

2) Në nenin 176 të KPRSH-së është parashikuar si vepër penale ***“Kontrabanda e vlerave kulturore”***.

Sipas kësaj dispozite ligjore, importimi, eksportimi apo tranzitimi i vlerave kulturore kombëtare në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me to, dënohen me burgim gjer në dhjetë vjet.

5. Veprat e tjera penale të këtij Kapitulli

Në Kapitullin e veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, janë parashikuar edhe këto vepra penale :

- Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin (neni 340);
- Dhënia e ndihmës veterinarë në mënyrë të pandërgjegjshme (neni 343);
- Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve (neni 346);
- Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme (neni 347);
- Shitja ose nxjerrja e trofeve të kafshëve të egra jashtë Republikës së Kosovës (neni 351);
- Shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës (neni 352) dhe
- Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore (neni 355).

SHTOJCË

I. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KAPITULLI XXVII

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE

Neni 338

Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit

1. Kushdo që duke shkelur ligjin, bën ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore, dënohet me gjobë ose burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në dy (2) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
7. Kushdo që e kryen veprën e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni si anëtar i grupit, dënohet me gjobë dhe burgim deri në katër (4) vjet.

Neni 339

Mbajtja e paligjshme e substancave dhe e mbeturinave të rrezikshme

1. Kushdo që duke shkelur ligjin, hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca të rrezikshme apo mbeturina që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në katër (4) vjet.
2. Kushdo që duke shkelur ligjin hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca apo mbeturina radioaktive që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
5. Nëse vepra nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.
6. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose me dëm substancial material të pasurisë, kafshëve apo bimëve ose me keqësimin substancial material të cilësisë së ajrit, ujit ose tokës, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 340

Lejimi i kundërligjshëm i ndërtimit apo drejtimit të fabrikave dhe instalimeve që ndotin mjedisin

1. Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit, lejon ndërtimin apo instalimin e fabrikës ose drejton apo menaxhon fabrikën ose instalimin në të cilën kryhet veprimtari e rrezikshme dhe me këtë rrezikon të shkaktojë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi, ndotë mjedisin, ajrin, tokën apo ujin ose shkakton dëm në shumë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë të kafshëve, bimëve ose pasurisë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Kushdo që duke shkelur ligjin lejon ose aplikon teknologjinë që ndot mjedisin ose territorin në shkallë të madhe, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

5. Kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmer masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

Neni 341

Dëmtimi i objekteve dhe pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit

1. Kushdo që dëmton, shkatërron, heq apo në mënyrë tjetër i bënë të papërdorshme objektet apo pajisjet për mbrojtjen e mjedisit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territorit të gjerë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territorit të gjerë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. dhe 4. i këtij neni rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

7. Kur shqipton dënimin për vepër penale nga ky nen, gjykata mund ta detyrojë kryesin që të ndërmer masa të caktuara për mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor.

Neni 342

Prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve

1. Kushdo që prodhon me qëllim që t'i shesë apo t'i vë në qarkullim materiet për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve, kur materiet e tilla janë të dëmshme për jetën apo shëndetin e tyre, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpendëve, kryesi dënohet me gjobe dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 343

Dhënia e ndihmës veterinare në mënyrë të pandërgjegjshme

1. Veterinari apo ndihmësi i autorizuar i veterinarit i cili me rastin e dhënies së ndihmës veterinare haptazi përshkruan ose aplikon mjetin e papërshtatshëm apo mënyrën jo të rregullt të mjekimit ose nuk përdor masat përkatëse higjienike apo në përgjithësi shkel rregullat e profesionit të veterinarisë gjatë procesit të mjekimit dhe me këtë shkakton sëmundjen, keqësimin e sëmundjes apo ngordhjen e shtazës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpezëve, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpezëve, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.

Neni 344

Ushtrimi i kundërligjshëm i shërbimeve veterinare

Kushdo që pa përgatitje adekuate profesionale merret me shërimin e shtazëve ose ofron shërbime tjera veterinare në kompensim të pagesës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në (6) gjashtë muaj.

Neni 345

Moszbatimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe të bimëve

1. Kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që gjatë periudhës së rrezikut ndaj botës bimore nga sëmundja ose murtaja, nuk respekton urdhrin apo vendimin e organit kompetent me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes ose të murtajës, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni rezulton me dëm të konsiderueshëm pasuror, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
6. Për qëllime të këtij neni, shprehja “blegtori” do të thotë çdo gjedh, bricjap, kalë, zog, shpezë, shpendë, bletë mjalti, dele, derr apo peshk.

Neni 346

Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve

1. Kushdo që keqtrajton kafshën ose përfshihet në çfarëdo akti seksual me kafshën për qëllime seksuale, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Për qëllime të këtij neni:
 - 2.1. “keqtrajtim” nënkupton veprimin apo mosveprimin me të cilin kafshës i shkaktohen vuajtje, dhembje apo shqetësime të rënda, të cilat në shkallën dhe rrethanat në të cilat paraqiten janë të tepruara dhe të panevojshme.
 - 2.2. “akt seksual” nënkupton penetrim sado i vogël i cilësdo pjesë të trupit të kafshës me organin seksual të personit, cilëndo pjesë tjetër të trupit të personit ose objektit për qëllime seksuale.
 - 2.3. “qëllim seksual” nënkupton çdo veprim i bërë për qëllimet e kënaqësisë seksuale të një personi.
3. Kushdo që organizon, financon ose është nikoqir i luftës ndërmjet kafshëve të llojeve të njejta apo të ndryshme ose organizon apo merr pjesë në bast në këto luftëra, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

4. Kushdo që me ndonjë materie helmuese apo të dëmshme e ndot ushqimin apo ujin e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, ose e ndot çfarëdo furnizimi ujorë natyrorë apo të bërë nga njeriu që siguron ujë për shtazë, shpezë, bletë, shtazë të egra apo peshq dhe me këtë rrezikon jetën apo shëndetin e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

5. Kushdo që me ndonjë materie helmuese apo të dëmshme e ndot çfarëdo uji dhe me këtë rrezikon ekzistencën e shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve në ujë, dënohet me dënimin nga paragrafi 4. i këtij neni.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 4. ose 5. i këtij neni rezulton me ngordhje të një numri të madh të shtazëve, shpezëve, bletëve, shtazëve të egra apo peshqve, në vlerë që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

7. Nëse vepra penale nga paragrafi 4. ose 5. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.

Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 347

Shkatërrimi i botës bimore me materie të dëmshme

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin dhe me përdorimin e materies së dëmshme, shkakton shkatërrimin e bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër dhe me këtë shkakton dëm në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj llojit veçanërisht të mbrojtur të bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj. Nëse vepra penale nga paragrafi 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Neni 348

Shkretërimi i pyjeve

1. Kushdo që në kundërshtim me ligjin ose urdhrin e organit kompetent, bën prerjen apo shkatërrimin e pyllit ose në ndonjë mënyrë tjetër shkretëron pyjet, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm apo kur vepron si anëtar i grupit të njerëzve, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Neni 349

Vjedhja e pyllit

1. Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të shitjes, ose sasia e druve të prerë tejkalon pesë (5) metra kub, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në katër (4) vjet.

3. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet:

3.1. në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm;

3.2. me qëllim që drunjtë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

4. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

Neni 350

Gjuetia e kundërligjshme

1. Kushdo që gjuan kafshë të egra kur gjuetia është e ndaluar ose në territorin në të cilin gjuetia është e ndaluar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

2. Kushdo që pa leje ose autorizim, gjuan ose mbyt një kafshë të egër ose e zë të gjallë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet jashtë sezonës; në grup; ose ndaj gjahut në vlerë që tejkalon dymijë (2.000) Euro ose me rëndësi sipas rregulloreve të gjuetisë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

4. Kushdo që gjuan lloje të rrezikuara ose të rralla të kafshëve, gjuetia e të cilave është e ndaluar, ose gjuan lloje të posaçme pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

5. Kushdo që gjuan duke përdorur metoda të asgjësimit masiv, duke përdorur automjetin ose duke përdorur dritën e fortë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

6. Kafshët e egra dhe pajisjet e gjuetisë konfiskohen.

Neni 351

Shitja ose nxjerrja e trofeve të kafshëve të egra jashtë Republikës së Kosovës

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Republikës së Kosovës trofenë nga kafshët e egra, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Republikës së Kosovës trofenë nga kafshët e egra të fituar me anë të veprës penale nga paragrafët 1. deri 3. të nenit 350 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Trofetë e kafshëve të egra konfiskohen.

Neni 352 Shitja ose nxjerrja e të mirave natyrore, bimëve ose kafshëve posaçërisht të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Republikës së Kosovës të mira, bimë apo kafshë posaçërisht të mbrojtura, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 353

Peshkimi i kundërligjshëm

1. Kushdo që peshkon gjatë kohës kur peshkimi është i ndaluar apo në ujërat ku peshkimi është i ndaluar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj.
2. Kushdo që peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese dhe me këtë shkakton ngordhjen e peshqve në mënyrë të tillë që të dëmtojë shumimin e peshqve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Neni 354

Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës

1. Kushdo që dëmton ose shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror që kanë vlerë të posaçme ose nëse vepra penale rezulton me dëm të rëndë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
3. Kushdo që pa autorizimin përkatës të organit kompetent nxjerr jashtë Republikës së Kosovës monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

4. Nëse vepra penale nga paragrafi 3. i këtij neni ka të bëjë me monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

5. Për qëllime të këtij neni, shprehja “monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror” do të thotë objekt nderimi i një komuniteti fetar i cili ndodhet në pronën e caktuar për shërbime fetare, gur varri, varr apo vend tjetër i varrimit, monument publik, monument natyror, objekt artistik, shkencor apo artizanat i cili ruhet në koleksione publike ose në ekspozita publike, objekt i cili shërben për ndonjë nevojë publike ose zbukuron rrugën publike, sheshin apo parkun, atraksion natyror apo një lloj të rrezikuar i kafshëve ose bimëve.

6. Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1. ose 3. i këtij neni është e dënueshme.

Neni 355

Punimet e paautorizuara dhe përvetësimi i monumenteve kulturore

1. Kushdo që pa autorizimin e organit kompetent kryen punë të konservimit, restaurimit apo punime hulumtuese në ndonjë monument kulturor, ose përkundër ndalimit ose joautorizimit, kryen gërmime apo hulumtime arkeologjike dhe me këtë e shkatërron ose e dëmton rëndë monumentin kulturor apo karakteristikat e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj monumentit kulturor me vlerë apo me rëndësi të posaçme ose rezulton me dëm të madh, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet.

3. Kushdo që gjatë hulumtimeve arkeologjike apo të hulumtimeve të tjera përvetëson ose merr objektin e gërmuar apo objektin e gjetur në ndonjë mënyrë tjetër i cili paraqet monument kulturor, dënohet me dënimin nga paragrafi 2. i këtij neni.

II. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KREU IV

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Neni 201

Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës

(Ndryshuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Ndotja e ajrit, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet.

Po kjo veprë, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Kur kjo veprë ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë vdekjen e një ose disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 201/a

Menaxhimi i mbetjeve

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e venddepozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkelje të kërkesave të legjisllacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo veprë, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Ku nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/b

Transportimi i mbetjeve

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkelje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/c

Aktivitetet e rrezikshme

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/ç

Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në

cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Po kjo veprë kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzet vjet.

Kur kjo veprë kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

Neni 202

Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër (Ndryshuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Vrasja, shkatërrimi, zotërimi, marrja e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet.

Neni 202/a

Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër (Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Tregtimi i ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 202/b

Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore (Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 203

Substancat ozonholluese

(Ndryshuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Neni 204

Peshkimi i ndaluar

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 205

Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 206

Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë

Prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë.

Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.

Neni 206/a

Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

(Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013)

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Neni 206/b

Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

(Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008; ndryshuar fjalët në paragrafin e parë dhe të dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013)

Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 207

Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve

Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Neni 207/a

Braktisja e kafshës të shoqërimit

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Kur nga braktisja e kafshës së shoqërimit ose nga mosvendosja e maskës mbrojtëse kafshës së shoqërimit, në ambiente publike ose në mjedise të hapura për publikun, kanë ardhur pasoja në dëm të shëndetit të një personi, dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 207/b

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 207/c

Keqtrajtimi i kafshës

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Keqtrajtimi ose torturimi i një kafshe, duke i shkaktuar dëmtime të përhershme shëndetësore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 207/ç

Ndeshjet ndërmjet kafshëve

(Shtuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)

Promovimi, organizimi ose drejtimi i ndeshjeve ndërmjet kafshëve që shkaktojnë vuajtjen ose torturimin e kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Dhënia e kafshëve për ndeshje, rritja ose trajnimi i kafshëve me qëllim përdorimin apo shitjen për ndeshje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Vënia e basteve në ndeshje të zhvilluara midis kafshëve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e kafshës, dënohet me burgim deri në gjashtë muaj.